



# Gazeta Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XXIV i botimit, nr. 270, prill 2026**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: [www.shoqatadukagjini.com](http://www.shoqatadukagjini.com), Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## U mbajt në Deçan Manifestimi Tradicional “Zëri i Vëllazërisë 2026” **3**


### 85- Vjetori i Luftës së Gurit të Kuq

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe ajo kulturore-artistike "Besashosh", me 19 prill 2026, në bashkëpunim me bibliotekën "Marin Barleti", në ambientet e saj, u zhvillua veprimtaria përkujtimore me rastin e 85- vjetorit të Luftës Gurit Kuq, mes patriotëve Dukagjinas dhe ushtrisë Jugosllave, në një ndeshje thellësisht të pa barabartë, e cila përfundoi me një fitore të thellë të vendasve.

### Çështja e Orientit dhe Shqipëria **4**

Me datën 18 prill, ora 10.30, në Bibliotekën e qytetit të Shkodrës u mbajt promovimi i librit "Çështja e Orientit dhe Shqipëria" të autorit shkodran Gaspër Jakova Mërturi, botuar dhe përkthyer nga znj. Fitije Picari, një aktiviste e shquar në Rovena të Italisë.

Ajo, duke gjurmuar në biblioteka të ndryshme të Italisë, ka zbuluar dorëshkrime dhe libra të mbuluar nga plumburi i kohës, vepra të autorëve me origjin shqiptarë, të panjohur më parë...



# AKADEMIKU REXHEP QOSJA ËSHTË SHUAR NË MOSHËN 90-VJEÇARE

## Njoftimi i familjes:

Njoftojmë se sot, më datë 23.4.2026 është ndarë nga jeta dhe është varrosur Rexhep Qosja. Varrimi u zhvillua në praninë e anëtarëve të ngushtë të familjes. Me dëshirë të të ndjerit, nuk do të organizohet ceremoni pritjeje nga familja. Familja nuk do të marrë pjesë në organizime institucionale. Lusim që privatësia jonë të respektohet dhe të na mundësohet të mbajmë zi në qetësi!

## Kush ishte Rexhep Qosja

Qosja ishte një nga figurat më të rëndësishme të mendimit dhe letërsisë shqiptare, me një karrierë të gjatë akademike, letrare dhe publike në Kosovë dhe më gjerë.

Ai lindi më 25 qershor 1936 në Vuthaj dhe është formuar si studiues i letërsisë shqipe në Prishtinë dhe Beograd, ku përfundoi studimet universitare dhe doktoraturën. Qysh në vitet '60 u angazhua në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku më vonë u bë edhe drejtues i tij, si dhe profesor në Universitetin e Prishtinës.

Qosja ishte autor i dhjetëra veprave në fushën e kritikës letrare, studimeve albanologjike, eseistikës, dramës dhe prozës artistike. Ndër romanet e tij më të njohura janë "Vdekja më vjen prej syve të tillë", "Një dashuri dhe shtatë faje", "Nata është dita jonë" dhe "Bijtë e askujt". Ai është konsideruar një nga zërat më të rëndësishëm të modernizimit të dramës shqipe në vitet '70.

Në planin intelektual, Qosja ka qenë një debatues i fortë publik, veçanërisht në çështjet e identitetit kombëtar shqiptar, ku ka hyrë në polemika të njohura me Ismail Kadare mbi përkatësinë evropiane dhe kulturore të shqiptarëve.

Përveç veprimtarisë letrare dhe akademike, ai është angazhuar edhe në jetën politike të Kosovës në vitet '90, duke organizuar forume intelektuale dhe duke marrë pjesë në procesin e Rambujesë gjatë periudhës së luftës. Pas luftës, ka qenë pjesë e strukturave këshillimore politike në Kosovë.


Qosja ka qenë gjithashtu një zë kritik ndaj elitës politike dhe kulturore shqiptare në periudha të ndryshme dhe është përfshirë në debate të rëndësishme mbi identitetin, historinë dhe orientimin politik të shqiptarëve.

## Biografia

Lindi më 1936 në Vuthaj të Malit të Zi. Katër klasat e para të fillores i kreu në Vuthaj, kurse gjysmëmaturën në Guci. Më 1959 mbaroi Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa më 1960 u regjistrua në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, ku u diplomua më 1964. Në vitin 1967 u pranua asistent në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe gjatë viteve 1967/68 spe-

cializoi shkencën e letërsisë në studimet e shkallës së tretë në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit. Më 1969 u zgjodh bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në vitin 1971

shkencore e letrare, duke trajtuar në to çështje të veçanta të letërsisë shqipe dhe të krijimtarisë letrare në përgjithësi. Disa punime dhe vepra të tij janë përkthyer në gjuhë të tjera.



mbrojti tezën e doktoratës mbi jetën dhe krijimtarinë e Asdrenit. Pas doktorimit, më 1972, u zgjodh, një herë bashkëpunëtor i lartë e pastaj, këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik, si dhe profesor inordinar dhe profesor ordinar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ishte drejtor i Institutit Albanologjik prej vitit 1972 deri më 1981, shef shumëvjeçar i Degës së Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filozofik dhe, gjatë viteve 1974-1975, kryeredaktor i jashtëm i revistës letrare Jeta e Re.

Është autor i mbi tridhjetë librave me studime për letërsinë dhe kritikë letrare, prozë artistike, tregime, romane dhe drama, publicistikë e shkrime polemike. Ka botuar shumë recensione, vështrime, artikuj, sprova, trajtesa e studime në revista

Për krijimtarinë shkencore e letrare është çmuar me: Shpërblimin e qytetit të Prishtinës, më 1968; me Shpërblimin Krahinor të Dhjetorit më 1969; me dy shpërblime të SHSH të Kosovës, më 1972 dhe 1974 dhe me Shpërblimin e RS të Serbisë – "7 Korriku", më 1975, me Çmimin "Pjetër Bogdani", 2010 për romanin "Bijtë e askujt", etj. Është marrë edhe me veprimtari politike; në periudhën 1998-2000 drejtoi një parti politike në Kosovë. Në vitin 2000 kryetari i Republikës së Shqipërisë i dha çmimin "Nderi i Kombit".

## BIBLIOGRAFIA

### Vepra në gjuhën shqipe:

1. Episode letrare, Rilindja, Prishtinë, 1967.

2. Dialogje me shkrimtarët, Rilindja, Prishtinë, 1968.
3. Kritika letrare, Rilindja, Prishtinë, 1969.
4. Antologjia e lirikës shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1970.
5. Kontinuitete, Rilindja, Prishtinë, 1972.
6. Asdreni – jeta dhe vepra e tij, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1972.
7. Panteoni i rralluar, Rilindja, Prishtinë, 1973.
8. Vdekja më vjen prej syve të tillë, Rilindja, Prishtinë, 1974.
9. Shkrimtarët dhe periudha, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1975.
10. Anatomia e kulturës, Rilindja, Prishtinë, 1976.
11. Mite të zhveshura, Rilindja, Prishtinë, 1978.
12. Prej tipologjisë deri te periodizimi, ASHAK, Prishtinë, 1979.
13. Morfologjia e një fushate, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1980.
14. Nocione të reja albanologjike, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1983.
15. Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I-II-III, Rilindja, Prishtinë, 1984-1985.
16. Antologjia historike e letërsisë shqipe. Poezia dhe Proza, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1985.
17. Porosia e madhe, Prishtinë, 1986.
18. Populli i ndaluar, Prishtinë, 1990.
19. Fjalori demokratik, Prishtinë, 1997.
20. Çështja shqiptare, Historia dhe politika, Prishtinë, 1998.
21. Ligjërime paravajtëse, Prishtinë, 1998.
22. Strategjia e bashkimit kombëtar, Prishtinë, 1998.
23. Paqja e përgjakshme, Konferenca ndërkombëtare për Kosovën, Prishtinë, 1999.
24. Tronditja e shekullit I, Tiranë, 2001.
25. Tronditja e shekullit II, Tiranë, 2001.
26. Një dashuri dhe shtatë faje, roman, bot. Toena, Tiranë, 2001.
27. I ringjalluri i penduar, tregim satirik. Toena, Tiranë, 2002.
28. Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne – Shkrimtarë dhe periudha, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2006.
29. Ideologjia e shpërbërjes, trajtesë mbi idetë çintegruese në shoqërinë e sotme shqiptare Toena, Tiranë, 2006.
30. Realiteti i shpërfillur, Vështrim kritik mbi pikëpamjet e Ismail Kadaresë për identitetin shqiptar, Toena, Tiranë, 2006.
31. Të vërtetat e vonuara: përgjigje e dytë në polemikat e Ismail Kadaresë dhe të bashkëmendimtarëve të tij, Toena, Tiranë, 2006.
32. Rilindja e dytë, Toena, Tiranë, 2007.
33. Nata është dita jonë, Toena, Tiranë, 2007.
34. Bijtë e askujt, I dhe II, Valdoli, 2010.

Në vitin 2010 Instituti Albanologjik i

# U mbajt në Deçan Manifestimi Tradicional “Zëri i Vëllazërisë 2026”

E shtuna e 25 Prillit 2026, shënoi në këtë ditë të bukur pranverore plot gjallëri, emocion dhe reflektim, Manifestimin Tradicional “Zëri i Vëllazërisë 2026” e organizuar nga Shoqata “Martin Dreshaj” më qendër në Pejë në Bashkëpunim me Komunën e Deçanit, më pjesëmarrje të Shoqatave e Ansambleve bashkëpunuese nga trojet etnike.

Shoqata “Martin Dreshaj” çdo vit organizon Manifestimin Tradicional “Zëri i Vëllazërisë”, në muajin Prill, në përkujtim të Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911 dhe në nderim të kontributit të Malësorëve gjatë luftës në Kosovë kundër pushtuesit Serb, Serbia okupatore fashiste. Në këtë Manifestim morën pjesë Shoqata Atdhetare “Dukagjini” Shkodër, Shoqëria Kulturore Artistike “Besa – Shosh”, Shkolla 9 vjeçare Hoti i Ri – Shkodër; Malësia e Madhe Tuz, Ansambli “Drenica” Skenderaj, Solistja e mirënjohur Valbona Krasniqi nga Malisheva, Këngëtarë mirënjohur Fatmir Berisha nga Klina, Ansambli “Vullkani” Istog, Ansambli Autokton “Rugova”, Ansambli i Këngëve dhe Valleve në Deçan dhe Skoolla 9 vjeçare (SHFMU) “Dëshmorët e Dukagjinit” në Glllogjani.

Në fillim të gjitha Ansamblet dhe Shoqatat u takuan në Kompleksin e Varrezave në fshatin Glllogjan, u bënë Homazhe, u vendosën kurora me lule dhe Nderim për Dëshmorët e Kombit. Këtu prehen 87 Dëshmor të luftës së vitit 1998 - 1999.

Një historik mbi fillimin dhe luftën e lavdishme të UÇK-së e mbajti përgjegjësi i Kompleksit Memorial, z. Xhafer Sejfiqaj, i cili në mes të tjerave tha: Këtu prehen Dëshmorët jo vetëm nga Dukagjini, por edhe nga Shqipëria e nga Plava e Gucia,

kjo dëshmon së shqiptarët janë një dhe të pandare.

Kurora me lule në nderim të Dëshmorëve vendosi kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në Shkodër z. Ndue Sanaj dhe Ndoc Fusha, nga Shoqata “Martin Dreshaj” sekretari Frasher Racaj, Marash Dedvukaj, Ali Tahiri dhe Imer Loshi nga Ansambli “Drenica” Skenderaj.



lën e Hoti të Ri nga Shkodra, me iniciativë e Shoqatës “Martin Dreshaj” dhe e përkrahur nga kryetari i Komunës Deçan, z. Bashkim Ramosaj dhe Drejtoria e shkollimit të Komunës së Deçanit.

Vizita në Shkollën e Glllogjanit ishte mahnitëse nga pritja vëllazërore e personelit të Shkollës dhe në veçanti nga Drejtorja e kësaj Shkolle, znj. Lumnije Lushaj Avdiu, e cila u bë protagonistja kryesore për pritjen dhe shoqërimin e pjesëmarrësve të Manifestimit “Zëri i Vëllazërisë 2026”. Vlerë e veçantë e kësaj vizite ishte edhe shkëmbimi i dhuratave dhe mirënjohjeve në mesë dy shkollave nga Drejtoria e Shkollës 9 vjeçare të Hotit të Ri dhe Shkollës “Dëshmorët e Dukagjinit” në Glllogjan. Pjesëmarrësit u njohën me Historinë e kësaj shkolle.

Pjesa e tretë takimit u zhvillua në Qendrën Rinore “Fitnete



Pas vizitës në Kompleksin e Dëshmorëve dhe varrezave ku prehen Dëshmorët e Kombit të gjithë pjesëmarrësit morën rrugën për vizite në SHFMU “Dëshmorët e Dukagjinit”, që tani e dy vite më parë u bë Binjakëzimi me Shkol-

Ramosaj”, në të cilën u prezantua një program i pasur artistik dhe ku veçua bashkëpunimi në mesë këngëtarëve nga Shkodra dhe Dukagjini, dominuan vargjet e poetit të talentuar Lulash Brigja, i cili në vargun e tij dominon bashkimi dhe atdhetashu-

ria ndaj Atdheut.

Fillimisht SHFMU e hapi programin me një valle dhe një recitim aktual me porosi mos i lëshoni trojet, Për të vazhdua më Ansamblin e Këngëve dhe Valleve nga Deçani, me vallen dyshe, derisa në skenë u duartrokoi fort këngëtarja nga Malisheva, Valbona Krasniqi, me këngën, me titull “Moj ushtria Çlirimtare”, me muzikë e orkestrim Hysni Klinaku.

Me duartrokitje të veçanta u prit kënga me këngën “Gjuha e Gjaku nuk ndahen përjetë”, me tekst nga Lulash Brigja dhe me muzikë e orkestrim Arben Bytyçi, e kënduar nga këngëtarë Fatmir Berisha e Ndoc Fusha.

Shoqëria Artistike “Besa – Shosh” u paraqit me Rapsodët Gjon Kosteri, Ndoc Fusha, Kolë Martin Aramadhi dhe Ndue Kole Fusha.

Ndera Ansambli “Drenica” nga Skenderaj u paraqiten me këngën “Ahmet Delia dhe erdha nga Tirana”. Ansambli “Vullkani” nga Istogu u paraqiten me dy këngë e dy valle.

Ansambli Autokton “Rugova” u paraqit me vallen e Rugovës. Me këtë rast përshëndeti dhe Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i cili vlerësoj lartë bashkëpunimin e ndërsjellët në mes shoqatave, me sloganin “Jemi vëllazër të një gjaku, qajmë e qeshim së bashku”, si dhe ngriti lartë vlerat e shoqatës “Martin Dreshaj” në bashkëpunimin me pushtetin vendor, që ne, në Shkodër duhet të marrim shembull. Pastaj në emër të Kryesisë së Saj, Prof. Dr. Luljeta Pula ju dorëzua titulli “Anëtare Nderi e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, me motivacion: “Për kontributin e çmuar atdhetar, angazhimin intelektual në çështjen Kombëtare dhe për lidhjet e vijueshme shpirtërore e bashkëpunuese me shoqatën atdhetare “Dukagjini” dhe gazetën e saj; në shërbim të lirisë dhe vlerave kombëtare”

Në përfundim të Manifestimit u ndan Mirënjohje dhe nga Komuna e Deçanit u shtrua një Dreke e përbashkët për të gjithë pjesëmarrësit e Manifestimit Tradicional “Zëri i Vëllazërisë 2026”. Drejtoji veprimtarinë artistike të Manifestimit poetja Leonora Lokaj, e cila me fjalën e saj dhe prezantimin e mrekullishëm e mbajti publikun më emocion.

Në fund pjesëmarrësit u shpendinë në drejtimet e tyre, me shprehjen vëllazërore “Mire u takofshim në veprimtari të tjera!”

**Frashër RACAJ dhe Roza PJETRI**

Prishtinës botoi kompletin e veprave në 29 vëllime, i cili në pesë cikle përmban këto vepra:

## I. Veprat historiko-letrare:

1. Vazhdimësi,
2. Panteoni i rralluar,
3. Asdreni – jeta dhe vepra,
4. Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne,
5. Anatomia e kulturës,
6. Nacione të reja albanologjike,
7. Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi 1, Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi 2, Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi 3,
8. Porosia e madhe,
9. Tri mënyra të shkrimit shqip,
10. Semantika e ndryshimeve historiko-letrare.

## II. Veprat letrare:

11. Antologjia e lirikës shqipe,
12. I ringjalluri i penduar,
13. Mite të zhveshura,
14. Vdekja më vjen prej syve të tillë,
15. Një dashuri dhe shtatë faje,
16. Nata është dita jonë,
17. Bijtë e askujt 1, Bijtë e askujt 2. III. Veprat historike dhe historiko-dokumentare:
18. Çështja shqiptare – historia dhe politika,
19. Programet serbe për shpërnguljen e shqiptarëve,
20. Paqja e përgjakshme,
21. Tronditja e shekullit 1, Tronditja e shekullit 2,
22. Rilindja e dytë. IV. Veprat publicistike:

23. Populli i ndaluar,
24. Strategjia e bashkimit shqiptar,
25. Ligjërime paravajtëse,
26. Fjalor demokratik,
27. Demokracia e shpërdorur,
28. Intelektualët, etika dhe politika. V. Veprat polemike:

29. Morfologjia e një fushate, Ideologjia e shpërbërjes, Realiteti i shpërfillur, Të vërtetat e vonuara.

## Vepra të përkthyer në gjuhë të tjera:

1. Ziva sfinga, Jedinstvo, Priština, 1976.
2. Smrt vreba iz očiju, Narodna knjiga, Beograd, 1976.
3. Knjizevnosti i kritika, Prosveta, Beograd, Jedinstvo, Priština, 1979.
4. Smrt preži v očeh, Mladinska knjiga, Ljubljana, 1979.

5. Smrta mi ide ot takiva oči Hristo Danov, Plovdiv, 1982.
6. Beselam pse më flijojnë (arabisht), Kuvajt, 1983.
7. La mort me vient de ces yeux là, Gallimard, Paris, 1994.
8. La question Alabanaise, Fayard, Paris, 1995.
9. In solchen Augen liegt der Tod, Hayman Verlag, Innsbruck, 1995.
10. Die ogen en de dood, Van Genep, Amsterdam, 1996.

LAVDI jetës e veprës së Akademikut Rexhep Qosja!

**REDAKSIA**

# 85- Vjetori i Luftës së Gurit të Kuq

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe ajo kulturore-artistike "Besa-Shosh", me 19 prill 2026, në bashkëpunim me bibliotekën "Marin Barleti", në ambientet e saj, u zhvillua veprimtaria përkujtimore me rastin e 85- vjetorit të Luftës Gurit Kuq, mes patriotëve Dukagjinasi dhe ushtrisë Jugosllave, në një ndeshje thellësisht të pa barabartë, e cila përfundoi me një fitore të thellë të vendasve.

Në këtë veprimtari mori pjese Zv/Prefektja e Qarkut Shkodër, zj. Amila Gjyzezi; administratori i Njësisë administrative të Shalës, z. Preke Doci; Kryetari i shoqatës së Miqesise Kosove Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" me qendër në Peje, z. Ukshin Jashari; Kryetari i shoqatës "Lëvizja për Shqipërinë e Bashkuar", me qendër në Prishtinë, z. Frashër Racaj; N/kryetari i shoqatës "Shqiptaria", me qendër në Prishtinë, koloneli në pension Hysen Gecaj; anëtar të Shoqatës atdhetare "Dukagjini", malësorë e malësore të Dukagjinit, përfaqësues të Malësisë së Madhe, të Shoqatës së Ushtarakëve Shkodër, poete e shkrimtar nga të gjitha trevat e

veriu.

Veprimtaria u drejtua nga Kryetari i Shoqatës "Dukagjini", z. Ndue Sanaj.

Folësit e ndryshëm, si z. Pal Shkëmbi, Prele Milani, Kole Vladaj, poetja Mimoza

Rexhvelaj, kolonel Hysen Gecaj e Frashër Racaj, që morën fjalën ngritën lart patriotizmin dhe ndjenjat e atdhetarisë, të malësorëve të kësaj zone dhe në veçanti të krahinës së Shoshit, të cilat në të gjithat



## Lufta anti Jugosllave e Gurit të Kuq, prill 1941

85 vite ma parë, në Vendin e quajtur Guri i Kuq, territor i krahinës së Shoshit, kufij me krahinen e Pultit, u zhvillua finalja e tmerrshme e luftës Italo-Jugosllave të vitit 1941 e iniciuar nga fuqitë kundërshtarë të luftës së dytë botërore në territorin e Shkodrës. Kjo sfidë sa madhështore edhe spektakolare çuditërisht aq e ndaluar në diktaturë, e shumë përfolur dhe e pa vlerësuar ende sot. Kjo luftë duhet parë dhe vlerësuar, së pari me kontekstin historik, ndërkombëtare dhe së dyti në planin shqiptar dhe krahinor ku u zhvillua.

Kjo luftë ishte vërtetë e çuditshme, madje e tillë misterioze dhe çuditërisht pa as një përkujtesë kombëtare mbetet edhe sot. I çuditshëm është fakti se si jugosllavët nga njëra anë, bënë një pakt neutraliteti me Hitlerin, ndërsa nga ana tjetër, pranuan të merrnin një inkursion goditës ndaj aleatit të tij, Musolinit nga toka shiptare ndërkohë kurë vetë kjo Jugullavi e kishte njohur pushtimin vendit tonë nga këmishat e zeza italiane, që në prill 1939. Kjo lojë e dyfishtë e mbretërisë hibride jugosllave, gjermanët i bëri xheloz dhe të pa tolerueshem, ndaj vendosën ta ndëshkonim pa mëshirë ish kukulleshën e tyre.

Enigmatike, dhelparake dhe e shkathët u tregua diplomacia angleze, e cila ishte e bindur plotësisht se gjermanët nuk do ta lejonin Jugosllavinë të dilte jashtë orbitës Hitleriane. Diplomacia angleze në lojën e sajë u tregua më e aftë dhe një hap përpara asaj gjermane, duke e bërë për vete Jugosllavinë, duke e kurdisur për një sulm të gjerë në prapavijen italianë në tokën shiptare në tre drejtime.

Nga Malesia e Gjakovës në Dukagjin dhe Shkodër, nga Dibra deri në Lumin Mat dhe nga Hani i Hotit në Shkodër deri në Mat. Ky aksion më shumë politik se sa ushtarak u përgatit në nxitim e sipër dhe pa një strategji të qartë, por që ishte tërësisht në favor të interesave strategjike të Luftës kundër fuqive të Boshtit në rajonin e Ballkanit, por jo në favor të shqiptarëve.

Mister i çuditshëm mbetet se çfarë ju premtua Jugosllavisë në kurriz të tokave shqiptare për këtë inkursion ushtarak, ndërkohë kur Jugosllavia endemike kërcënohej nga Germania e pathyeshmja e Evropës?

Tashmë kjo është ditur pavarësisht se sot askush nuk do pranojë se Jugosllavisë për këtë inkursion iu premtua më se pakti veriu shiptar deri në Mat. I çuditshëm, naiv i pa studiuar mirë ishte edhe pjesëmarrja në këtë invadim anti italian dhe e shumë eksponentëve shqiptar, të cilët tentuan të kapërcenin me një hap ledhin e pa kalueshëm të armiqësive historike të shqiptarëve të veriut me serbet.

Malësoret tanë nuk kishin faj ta kuptonin nëse jugosllavët po vinin si miq apo si armiq, madje misteri i plotë i këtij marshimi "shpëtimtar" ende sot nuk është zbardhur plotësisht. Serbet dhe malazetët kurrë nuk kishin ardhur si miq në malet tona. As kush nuk u tha se do vinin si miq dhe çfarë është më e rendësishmja ata u sollën si pushtues mizor. Si ka mundësi që një ushtri gjoja aleate që vinte të na çlironte në mesin e udhës kaloi në veprime represive, grabitjet masive dhe masakrimi i civilëve të pa fajshëm është fakt i pa mohueshëm

si drita e diellit se, u plaçkiten në mënyrë të pa mëshirshëm katundet Ndreaj, Pepaj, Celaj Dardhë, Gurrë, Nicaj, Palaj dhe Prekal ndërkohë që gjatë shtegimit të njëjten gjë pësuan Kiri, Xhani, Temali dhe Ura e Shtrenjtë e të tjera. Ata që u vranë dhe u varrosën për së gjalli ishin banoret e Dukagjinit dhe jo italianët. Deri më sot nuk kemi as një konfirmim për asnjë ushtarë italian të vranë nga marshimi Jugosllave. Sa shkelën në tokën e Shoshit tek Livadhet e Brashtës karshi Qafës së Agrit u vra Pal Mirashi i Brashtës, që pati guxim të shtinte mbi kolonën që vinte si hije e zezë. Pas konfrontimeve sporadike në Qafe Astrës dhe Prekal me efektivet e milicisë në Koëer Shëngjeri dhe Prekal italianët u tërhoqën pa demë.

"Lufta e çuditshme e Gurit Kuq 1941", është trajtuar për herë të parë në kompletet e vet nga studiuesi Prel Milani, i cili është promovua në kuadrin e 80 vjeprit të kësaj lufte.

Unë si mësues i vjetër historie dhe njohës i kësaj ngjarje pajtohem plotësisht me kolegun tim, se kjo luftë nuk ishte as pro italiane, as aventurore plaçkitse, as e pararenduar me një udheheqës strategjik të qartë.

Lufta e Gurit të Kuq ishte produkt dhe pasojnë e luftës Italo-Jugosllave në territorin e Shkodrës. Dukagjini ishte viktimitë e kësaj përplasje gjeopolitike, dhe si viktimitë u detyrua të rezistojë në kufijte vetëmbrojtjes së domosdoshme, prandaj për grushtin dermues që i dha agresorit do ishte cinizëm ta quajë mëkatarrë. As populli i Shalës, as i Shoshit, as i Pultit nuk

periudhat historike, jo vetëm kanë dhënë kontribut të madhe, po dhe kanë derdhur gjakun e tyre për liri e pavarësi.

Nga folësit u ngrit problemi, që për këtë ngjarje nuk ka një lapidar, apo memorial, prandaj u shtrua si alternativë, që në se nuk e realizojnë strukturat shtetërore, vetë banoret e Shoshit, më në krye administratorin e Njësisë në mënyrë vullnetare ta bëjnë realitet, sa më shpejt të jetë e mundur.

Frashër Racaj, në emër të Shoqatës "Lëvizja për Shqipërinë e Bashkuar", z. Ndue Sanaj, i dorëzoi titullin "Mirënjohja", për kontributin e dhanë në realizimin e misionit të kësaj shoqate.

Gjithashtu në mbyllje të veprimtarisë, z. Ndue Sanaj njoftoi se, për të rënë të kësaj lufte u është bërë propozimi zyrtarë strukturave qendrore shtetërore, për t'ju dhënë statusin e "Dëshmorit të Atdeut", të cilën e presim të miratohet.

Me miqtë u shtrua një dreke.

\*\*\*

Për përgatitjen e zhvillimin e kësaj veprimtarie përkujtimore ndihmuan financiarisht Ndoc Fusha, Zef Toka e Mhill Shkami, të cilët i falënderojmë dhe ju urojmë me shprehjen popullore: Paçin e dhënçin!

pranoi të ngrihej me armët e Italisë kundër armatës Jugosllave, e cila erdhi e pa ftuar dhe e pa dëshiruar. Në konfrontimin qesharak jugosllavo-italian, ku as njëra palë, nuk ishin as të përgatitura, as nuk e dëshironin një ndeshje të vërtetë, dukagjinasi nuk u përfshinë, kurse Jugosllavët therën kopetë e Shoshit. Kur kërkuan me detyrim bukë, drithë, djathë, mish dhe tagji, atyre kur ata nuk i kishin as për vete. Kur ç'ka ishte ma tragjike detyruan Deli Sokolin, Ded Vuksanin, Martin Palin, Zef Delinë dhe Pjetër Delinë të hapnin një llogore misterize.

Llogrorja që hapën me mundim në Kodër të fshatit Dardhë, rezultoi varri kolektiv i tyre. I pushkatuan dhe dy prej të plagosur i mbuluan me dhe pa dhanë ende shpirt. Pas këtij momenti ushtria nuk ishte më as kalimtare aq më pak aleate, por vrasëse dhe plaçkitëse. Fushimi në Dardhë të Shoshit që i dhunshëm, u prenë pemët, u plaçkitën të gjitha shtëpitë, bagëtitë dhe gjithë tagjia kaloi për kafshët e ushtrisë. Prej aty u grabitën mizorisht të gjitha fshatrat e Shoshit.

**Tre janë faktorët përcaktues të një ndeshje spektakolare.**

Zgjedha e momentit të duhur për të filluar goditjen.

Vendin strategjik më të shkëlqyer rrugë drumit kryesor Prekal - Guri i Kuq. Guri i kuq ishte dhuratë hyjnore për vullnetarët pasi në asnjë pikë tjetër nuk mund ta sfidonin armatën Jugosllave.

Veprimi i shpejt dhe mjeshtria e bllokimit e shtegut të Gurit Kuq dhe nga drejtim i Gradilës dhe Birçave krijoi një panik dhe rëmuje të pa pare në radhë e ushtrisë jugosllave, që u fundos si titaniku në Luginën e Lebriqes

Versioni i lëvizjes së ushtrisë jugosllave sipas dëshmitë të kohës dhe dokumentimit në librin "LUFTA E ÇMENDUR E GURIT TË KUQ" e sqaruar në çdo detaj nga historiani dhe publicisti Prele Milani, Ushtria jugosllave ka qenë e përbërë nga dy

devizione, me komandë supreme dhe me armatim shumë të madh. Lëvizja e ushtrisë ka filluar nga Serbia, nëpër Kosovë, në Lekbibaj dhe janë drejtuar drejt Qafës së Agrit për të kaluar Shalë, Shosh, si synim arritja në Shkodër. Në kodër Shën Gjergj ishte e përqendruar posta e milicisë Italiane se Shqipëria ishte e pushtuar që nga viti 1939 nga Italia Fashiste. Komanda e ushtrisë Jugosllave nuk kishte dëshirë të konfrontohej me italianet. Për këtë u vendos që kjo ushtri të përqendrohej në Shosh, pas një konfrontimi të vogël me forcat e milicisë Italiane.

Me 9 prill 1941 një pjesë e kësaj ushtrie janë ndaluar në fushim, në vendin e quajtur FUSHA TE GJATA, AFËR QAFËS SË ASTRËS. Pjesa e madhe e ushtrisë së bashku me komandën janë përqendruar në lagjen Dardhë. Ushtrisë kishin filluar t'i mbaronin ushqimet. Kur u mor vesh ardhja e kësaj ushtrie burrat, gratë dhe të rinjtë së bashku me fëmijët nga frika e arrestimeve u larguan nga shtëpitë e tyre. Në shtëpia mbetën vetëm pleq dhe plaka. Filluan plackitjet në masë në DARDHË, GURRË, ÇILKOK, NICAJ, PALAJ dhe në fshatra të tjera të Shoshit. Ditën plackitnin ushqime, bagëti dhe cfarë gjenin, natën ktheheshin në fushim.

Ngjarja që ndezi shpirtin e urrejtjes kundër kësaj ushtrie pushtuese ishte, ngjarja e 11 prillit 41', kur me urdhër të komandës së ushtrisë për t'i futur tmerrin popullit të Shoshit në një gropë misterioze, që i detyruan ta hapnin vetë, i vranë dhe i varrosën të gjallë 5 djem dhe burra të kësaj krahine, të cilët i cituam më sipër.

Me datën 15 prill 1941 pjesa e madhe e kësaj ushtrie me në kry komandën kryesore i janë drejtuar MALIT TË SHOSHIT, rrugës së GURIT TË KUQ për në PREKAL me drejtim SHKODRËN.

Një pjesë e vogël e kësaj ushtrie i janë drejtuar KIRIT e XHANIT, drejt QAFËS SË BESHKASIT. Për t'u mbrojtur nga

luftëtarët e kësaj zone, kjo ushtri morin nën vrejte fratin e Kirit, PATËR MHILL MARJANIN dhe 54 burra të këtyre dy fshatrave, që t'u shpëtonin konfrontimeve.

Pjesa e madhe e ushtrisë u përqendra në PREKAL, SHKALLË LOGJË, URA E SHTRENJTË. U mor informacion se ushtria Italiane ishte e përqendruar në MES. Për të mos patur ndeshje me këtë ushtri, ushtria jugosllave qëndroi në PREKAL, nga data 16 - 22 prill 1941.

Komandës së kësaj ushtrie i'u erdhi informacion nga koamda e ushtrisë Jugosllave se Beogradi ishte pushtuar nga forcat Naziste të Hitlerit. Morën urdhër që të ktheheshin nga kishin ardhur. Por në Shosh ishte hedhur kushtimi i luftës që të mos lejonon këtë ushtri që të kthejë më e gjallë nëpër Shosh, për arsye të ngjarjeve që kishin ndodhur në DARDHË.

Të parët vullnetarë që u bashkuan për të luftuar kundër këtij armiku mizor ishin nga GURRA, DARDHA, ÇILKOKU, NICAJT, PALAJT, e më vonë morën pjesë nga të gjithë fshatrat e Shoshit, u mendua nga këta luftëtarë trima që vendi më i përshtatshëm për ti bërë ballë kësaj ushtrie të madhe e të armatosur rëndë, ishte GURI I KUQ, në të dy anët e shpateve, shpellat, grykat, shtigjet, në BIRÇA dhe LBRIQE.

Lufta e përgjakshme mes luftëtarëve të Shoshit është zhvilluar duke njeh data 23 prill e vitit 1941. Nga heroizimi i këtyre luftëtarëve SHOSHJANË dhe pozicioni shumë i përshtatshëm, nga forcat e ushtrisë Jugosllave ka patur shumë të vrarë. Sipas dëshmimeve të luftëtarëve pjesëmarrës në atë betejë dhe sqarimit në detaje të kësaj lufte, në librin e shkrimtarit dhe historianit PRELË MILANI, "LUFTA E ÇMENDUR E GURIT TË KUQ", lufta mori rrjedhë tjetër kur u vra mitralieri më i fuqishëm i kësaj ushtrie dhe ky mitraloz u mor nga trimi i jashtëzakonshëm LULASH STAKA I ÇILKOKUT, i cili për fatin e gjithë atyre luftëtarëve të vërtetë që

kishin shkuar për të dhën jetën në luftë me këtë armik, diti të përdorte mirë mitralozin, që bëri kërdinë mbi armiqtë. Në këtë luftë, luftuan heroikisht të gjithë ata që morën pjesë, por për ti përmendur me emra është e vështirë pasi ishin të shumtë në numër.

Të gjitha këto gjenden të pasqyruara shkëlqyeshëm dhe me detaje në librin që u përmend me sipër. Pas një qëndrese të jashtëzakonshme dhanë jetën në këtë luftë KOLË QERIMI, nga ÇILKOKU I FSHATIT NICAJ, NIKË DELIA E PALË KOLA nga FSHATI PALAJ, pas vdekjes së tyre qëndresa u bë edhe më e fuqishme deri sa të gjithë ata ushtarë jugosllavë që mbetën të gjallë u detyruan të dorëzohen.

Asnjë rob i dorëzuar nuk u vra nga trimat e SHOSHIT, por i ushqyen dhe i përcollën deri sa dolën nga territori i SHOSHIT. Kjo ngjarje dëshmon se burrat e Shoshit nuk u shquan vetëm për trimëri, por mbi të gjitha për besën. Edhe ndaj armikut të dorëzuar, ata ruajtën nderin, duke treguar se vlerat shqiptare qëndrojnë mbi çdo fitore.

**Shoshjanë të vrarë në Gur të Kuq, prill 1941**

NR	EMRI	FSHATI
1	Martin Pali	Nicaj
2	Zef Delia	Nicaj
3	Dedë Vuksani	Gurrë
4	Deli Sokoli	Gurrë
5	Pjetër Delia	Gurrë
6	Pal Mirashi	Brashtë
7	Kolë Qerimi	Çilkok
8	Palë Kola	Palaj
9	Nik Delia	Ndregjinaj - Palaj

**Të vrarë nga krahinat e tjera gjatë invadimit Jugosllav, në muajin prill 1941**

NR	EMRI	FSHATI
1	Vatë Pepa	Kir
2	Pëllumb Gjoni	Xhan
3	Nikë Sokoli	Mgullë - Plan
4	Pjetër Ndou	Qukë - Shalë
5	Grimc Ndou	Lotaj - Shalë
6	Zef Gjergji	Gjonpepaj - Nikaj
7	Gjon Nocaj	Peraj - Mërtur
8	Gjokë Sadria	Pac - Mërtur
9	Martin Zhivani	Curraj I Poshtëm
10	Mhill Hajdari	Ura e shtrenjtë
11	Zef Toma	Plan

Të plagosur gjatë invadimit Jugosllav, në muajin prill 1941, në Dukagjin

1. Lulash Deda - Lotaj (u plagos në Gurë te Kuq)
2. Gjokë Mirashi - Vuksanaj (u plagos pas Q.Agrit)
3. Lulash Ndrethi - Çilkok
4. Dodë Nika - Ndreaj
5. Gjon Pal Leka - Xhan
6. Pal Mark Zeqiri - Palç
7. Vat Çuni - Brisë
8. Dedë Marku - Prekal
9. Zef Marku - Mgullë

\*\*\*

Të gjithë të renët në këtë luftë, janë nderuar nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me titullin "Mirënjohja", si dhe janë propozuar për tu nderuar me statusin e dëshmorit të atdheut.

Të pa harueshëm qofshin të gjithë ata luftëtarë, vullnetarë që morën pjesë në këtë luftë ata trima të vërtetë. I përjetshëm e i pavdekshëm qoftë kujtimi dhe emri i atyre që dhanë jetën në këtë luftë dhe ndeshje me këtë ushtri mizore.

**Përgatiti ZEF TOKA**



# Çështja e Orientit dhe Shqipëria

Me datën 18 prill, ora 10.30, në Bibliotekën e qytetit të Shkodrës u mbajt promovimi i librit “Çështja e Orientit dhe Shqipëria” të autorit shkodran Gaspër Jakova Mërturi, botuar dhe përkthyer nga znj. Fitije Picari, një aktiviste e shquar në Rovena të Italisë.

Ajo, duke gjurmuar në biblioteka të ndryshme të Italisë, ka zbuluar dorëshkrime dhe libra të mbuluar nga pluhuri i kohës, vepra të autorëve me origjinë shqiptare, të panjohur më parë që u përkasin shekujve XVIII-XIX. Kështu, ajo është përpjekur të risjell në dritë dorëshkrimet dhe botimet e harruar të autorëve shqiptarë në mërgim.

Libri është një vështrim historik, politik, diplomatik i Shqipërisë në harkun kohor 395-1905. Autori mbajti një konferencë mbi këtë temë në Romë, me 22 mars 1903, në sallën e Shoqatës së shtypit dhe po atë vit në Napoli, në Sallën Tarsia ku pati mjaft vlerësime. “Il Messaggero” i Romës, nr. 82, midis të tjerash, jep këtë gjykim dashamirës: “...Edhe pse galopante nëpër pesë shekuj dhe mijëra ngjarje me rëndësi të madhe, diti të ndalte vëmendjen e dëgjuesve të tij shumë të vëmendshëm te pikat që më së shumti i shërbenin çështjes së tij me një shpejtësi, thjeshtësi dhe efektshmëri mahnitëse.

Në promovim fjalën përshëndetëse, në emër të Drejtorisë së Bibliotekës, e mbajti znj. Sidita Halluni.

Për librin folën Andrea Llukani, redaktor i librit, dr. Andis Kraja-shefe e Departamentit të Historisë në Universitetin Luigj Gurakuqi, dhe vetë autorja e botimit dhe përkthimit të librit znj. Fitije Picari.

Në referimet e tyre ato përmenden çështjet themelore që Gaspër Jakova Mërturi kishte parashtruar në këtë libër, ku në vorbullën e ngjarjeve të asaj kohe dalin në pah problemet e mprehta të shoqërisë shqiptare me qëllim që ato të mos injorohen, por të merren parasysh e sidomos nga Italia.

Promovimi u drejtua nga Dr. Zenepe Dibra, e cila mbajti referimin “Gaspër Jakova Mërturi (1870-1941), një personalitet shkodran me veprimtari shumëdimensionale”, nëpërmjet së cilës, me zbulimet e fundit doli në dritë dhe u qartësua më thellë veprimtaria shumë dimensionale i këtij patrioti, si shkrimtar, gjuhëtar, historian, diplomat, gazetar, e të tjera.

Në fund autores së botimit dhe përkthimit, znj. Fitije Picari, nga Zenepe Dibra iu dhurua libri “Gruaja shqiptare në vështrimin e të tjerëve”, botuar në Shkodër, më 1912, si dhe bibliotekës që është duke u ngritur në Itali për emigrantët shqiptarë, por edhe opinionin italian, iu dhuruan dy libra “Fjalor enciklopedik i gruas shqiptare” botuar në Shkodër, më 2009, dhe “Shkodra -Histori që gjallon me reliket e saj”, botuar në Tiranë më 2024.

## Po kush ishte Gaspër Jakova Mërturi?

Gaspër Jakova Mërturi (1870-1941)-një personalitet shkodrane, me veprimtari shumë dimensionale: Klerik, gjuhëtar, publicist, historian.

Lindi në Shkodër, ku ndoqi shkollimin


fillor dhe të mesëm në Kolegjin Saverian. Ka mbajtur dy mbiemra Jakova dhe Mërturi ndoshta nga origjina e tij nga Mërturi, një krahinë që përmbledh disa fshatra të Pukës, por që përfshin edhe pjesë të Gjakovës. Mbas mbarimit të Kolegjit Saverian u shugurua prift katolik. Formimi i tij jezuit e vuri në kontakt me letërsinë klasike italiane dhe me humanizmin katolik, që do të ndikonin thellësisht në veprimtarinë e tij të mëvonshme letrare. Pas kësaj shërbeu në disa famulli të krahinave

riar interesat e tij shkencore shtriheshin në fushën e historisë dhe politikës shqiptare, gjë që shihet qartë në botimet e tij letrare dhe historike ku tregojnë një përpjekje për të bashkuar identitetin kombëtar shqiptar me mendimin evropian, si:

- Genealogie dei Principi Albanesi (1904)
- Il V centenario della nascita di Giorgio Kastrioti-Skanderbegh (1404-1904)
- Commemorazione storica (1904)

vetëm Evropës, por në mënyrë të veçantë për Italinë dhe Shqipërinë”

Si gjuhëtar u bë i njohur me veprën “Gramatika e gjuhës shqipe” (Gramatica della lingua Albanese, Frascati, 1904). Që në parathënie, autori shfaq mendimin e tij mbi njësimin e gjuhës letrare dhe këtu ai shprehet në favor të gegërishtes për dy arsye: sepse gegërishtja tregon në format etimologjike të krahasuara me shumë pastërti dhe së dyti raca gege është më e pastër etnikisht nga të gjitha tributë shq-



të vendit. Në një fazë të vonshme të jetës, Mërturi u largua nga priftëria, një kthesë që shënoi ndarjen e tij nga jeta fetare dhe orientimin drejt karrierës intelektuale e kombëtare. Megjithatë, shkollimi i tij jezuit vazhdoi të ndikonte në punën e tij, sidomos në interesin për prozën, metrikën klasike dhe filozofinë. Brenda qarqeve intelektuale shqiptare dhe italiane, ai u njoh si një dijetar dhe poliglot i kulturuar, që ndërthurte dimensionin fetar, politik dhe letrar. Pas largimit nga Shqipëria, Mërturi u vendos në Itali, ku u përfshi në rrjetet intelektuale italo-shqiptare të Romës dhe Fraskatit. Ai punoi mësues në Shën Demetrio Korona, një qytet dhe komunë në Provincën e Kozencës së Rajonit të Kalabrisë, në Itali. Aty ai dha mësim në Kolegjin Shën Adrianit të këtij qytetit dhe me vdekjen e Girolamo De Radës (Jeronim de Radës) në vitin 1903, ai që i pasoi atij në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Kolegjin e Shën Adrianit ishte pikërisht prifti Gaspër Jakova nga Shkodra.

Si shkrimtar, Mërturi njihet si poet që u përpoq të adaptonte format prozodike të Carduccit në poezinë shqipe, duke u larguar nga traditat e rrepta metrike. Edhe pse krijimtaria e tij poetike përshkruhet si e kufizuar, bashkëkohës si Luigj Gurakuqi, vlerësuan ambicien e tij teknike. Si histo-

- La questione d'Oriente e l'Albania (1905)
- GRAMMATICA della Lingua Albanese (1904)

Duhet theksuar se Gaspër Jakova Mërturi, mbajti një konferencë mbi temën “Çështja e Orientit dhe Shqipëria” në Romë më 22 mars 1903, në sallën e Shoqatës së Shtypit dhe po atë vit në Napoli në sallën Tarsia.

Reagimet e shtypit italian ishin shumë vlerësuese në lidhje me problemet që ai shtroi në këtë konferencë, që sipas tyre mund të bëhen temë për shumë artikuj interesantë. Ai diti tu ndalte tek pikat që më së shumti i shërbenin çështjes së tij me një kulturë befasuese për nga gjerësia, një hollësi intuitash, një saktësi dhe drejtësi gjykimi të rrallë.

Vetë Gaspër Jakova Mërturi në fillim të librit të sapo botuar “I dashur lexues” shprehet: Unë të paraqes ty lexues mik, në thjeshtësinë time të pafajshme, këtë vështrim të shkurtë historik jo për të bërë shfaqje të artit retorik apo të frazave pompoze, por për të paraqitur në mënyrë të shkurtër dhe të përmbledhur origjinën dhe zhvillimin e çështjes lindore deri në ditët tona duke përfunduar pastaj me atë çështje më jetike që duhet të interesojë jo

iptare. Kjo vepër e botuar në italisht, me 217 faqe, përfshin alfabetin, vërejtje mbi ortografinë shqipe, probleme morfologjike, dialogje, dy përralla, këngë popullore dhe një fjalorth shqip-italisht.

Alfabeti i tij ka 37 shkronja nga të cilat 26 kanë vlerë të njëjtë me shkronjat e sotme. Rëndësi i ka dhënë edhe “ë” fundore ku ka dhënë disa rregulla të përgjithshme të përdorimit të kësaj zanoreje. Po kështu zënë vend edhe problemet morfologjike.

Krahas shënimeve gjuhësore e drejtshkrimore ka futur në veprën e vet studimin e njohur të Pashko Vasës “Shqypnia e shqyptarët”, të cilin e ka nxjerrë nga “Alfabetarja e Stambollit” të vjetit 1879 si dhe mjaft lëndë folklorike. Prej faqes 168 deri në 186 ka përmbledhë disa këngë dhe vjersha popullore shqipe, ndër të cilat janë për t’u përmendë “Kanga e Brahim Pashës” e vjetit 1572, ashtu edhe rapsodia “Gjëto Bashë Muji”. Ndërmjet këtyre vjershave ka edhe disa të vetat, nga të cilat vërehet trilli poetik i vetë autorit. Është botuesi i parë i teksteve rapsodike, duke filluar me botimin e një kënge kreshnike shqiptare, “Të lumët na për t’ lumin Zot”. Është autori i parë, i cili që më 1904 botoi të plotë Eposin e Kreshnikëve.

Si gazetar ka bashkëpunuar me disa revista për probleme histor-

# Hysen Gecaj - rrugëtimi i një oficeri nga betimi te liria

Në historinë e afërt të shqiptarëve të Kosovës, ku përplasjet mes nënshtrimit dhe lirisë u bënë përditshmëri e dhimbshme, dalin në dritë figura që nuk u mjaftuan me rolin e dëshmitarit, por zgjodhën të jenë aktorë të drejtpërdrejtë të fatit kombëtar.

Një ndër këto figura është gjenerali në pension Hysen Gecaj, i lindur më 21 shkurt 1963 në Llaushë të Drenicës, një trevë që historia e ka mësuar të jetojë me pushkë në një dorë dhe me besë në tjetrën.

Formimi i tij profesional nisi në një nga institucionet më të rëndësishme ushtarake të kohës, Akademinë Ushtarake Tokësore në Beograd. Ishte një rrugë që i premtonte karrierë të sigurt brenda strukturave të ish-Jugosllavisë, por historia nuk e kishte caktuar Gecajn të mbetej në shërbim të një sistemi që mohonte identitetin e tij kombëtar.

Në një moment vendimtar, ai braktisi Armatën Jugosllave dhe u kthye në Kosovë, një akt që nuk ishte vetëm zgjedhje personale, por një deklaram i hapur i përkatësisë dhe përgjegjësisë ndaj kombit.

Vitet '90 shënuan një periudhë të organizimit të fshehtë dhe përgatitjes së rezistencës. Gecaj u rreshtua herët në këto përpjekje, duke iu bashkuar grupeve guerile shqiptare që punonin për të ndërtuar bazat e kryengritjes së armatosur.

Në qershor të vitit 1992, ai filloi stërvitjen e grupeve të para guerile në Drenicë, duke hedhur themele të rëndësishme për



një rezistencë që do të shpërthente disa vite më vonë. Kur lufta mori trajtë të hapur, ai ishte ndër ata që nuk munguan në momentet më të vështira. Pjesëmarrja e tij në luftimet e 5, 6 dhe 7 marsit 1998 gjatë sulmit të forcave serbe mbi familjen Jashari në Prekaz përbën një nga episodet më të rëndësishme të përvojës së tij luft-

tarake.

Ato ditë nuk ishin vetëm përballje ushtarake, por kthesë historike që e vulosi rrugën e pakthyeshme drejt lirisë. Gjatë luftës, Hysen Gecaj shërbeu në detyrën e zëvendëskomandantit të Brigadës 112 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe njëkohësisht ishte ndër themeluesit dhe pedagogët e Akademisë Ushtarake "Hamez Jashari". Në këtë rol, ai nuk kontribuoi vetëm në front, por edhe në përgatitjen profesionale të kadrove që do të bartnin mbi supë barrën e luftës dhe të shtet ndërtimit.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, rrugëtimi i tij nuk u ndal. Ai u bë pjesë e strukturave të reja të sigurisë së Kosovës, duke shërbyer në detyrën e komandantit të Akademisë së Nënoficerëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe më pas në detyrën e shefit të Departamentit për Trajnime dhe Ushtrime në Ministrinë e Mbrojtjes. Në këto detyra, ai kontribuoi në ndërtimin dhe profesionalizimin e kapaciteteve mbrojtëse të shtetit të ri.

Formimi i tij u pasurua më tej me stu-

dime në Akademinë Shtabnore në Vilnius, si dhe me trajnime të shumta në kuadër të standardeve të NATO-s në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqi dhe Gjermani. Kjo përvojë ndërkombëtare i dha dimension modern profilit të tij ushtarak, duke e lidhur me praktikën bashkëkohore të mbrojtjes dhe të lidërshipit.

Në shkurt të vitit 2019, ai doli në pension me gradën e kolonelit, ndërsa më pas u dekorua me gradën e gjeneralit në rezervë, një vlerësim që kurorëzonte një karrierë të gjatë në shërbim të atdheut. Por edhe pas uniformës, angazhimi i tij nuk reshti.

Në detyrën e nënkryetarit të Organizatës "Shqiptaria", ai vazhdon të kontribuojë në ruajtjen dhe promovimin e vlerave kombëtare, duke u bërë pjesë aktive e jetës shoqërore dhe historike.

Figura e Hysen Gecajt përfaqëson një brez që nuk e pranoi nënshtrimin si fat, por e sfidoi atë me dije, guxim dhe përkushtim. Nga akademitë ushtarake te fushëbetet e Drenicës dhe deri te ndërtimi i institucioneve të sigurisë së Kosovës, rrugëtimi i tij mbetet një dëshmi e gjallë se liria nuk është vetëm ideal, por edhe sakrificë, organizim dhe vizion.

Në një kohë kur historia kërkon të ruhet dhe të rrëfëhet me dinjitet, figura të tilla mbeten gurë themeli të kujtesës sonë kolektive, jo thjesht si emra, por si udhërrëfyes për brezat që vijnë.

PRELË MILANI

ike. Mërturi së bashku me italo-shqiptarin Anselmo Lorecchio gjatë qershorit 1904 botuan një gazetë të përditshme në gjuhën italiane Agenzia Balcanica ed Italiana, që fokusohet në politikë, financa dhe informacion tregtar.

Mërturi themeloi gjithashtu periodikun dyjavor The Herald of Albania (L'Araldo d'Albania), (Herald i Shqipërisë) që ishte një periodik dyjavor i themeluar më 15 shtator 1904, që shërbente si një burim informacioni për çështjet shqiptare në fillim të shekullit të 20-të. Më 15 shtator 1904, botoi në Romë revistën 2 javore "Lajmëtar i Shqypënie", me pseudonimin Conte Vladany. Revista trajtoi probleme të karakterit politik, kulturor, shoqëror e letrar. Me interes të veçantë paraqesin artikujt studimorë mbi demografinë dhe historinë e Lidhjes së Prizrenit. Kjo revistë propagandoi bashkimin e popullit për pavarësinë kombëtare dhe demaskoi synimet shoviniste të mbretërve fqinjë.

Duke lexuar librin "Çështja e Orientit dhe Shqipëria" të bën përshtypja, që megjithëse ishte prift, ai kishte konsideratë për patriotizmin e myslimanëve shqiptarë, duke thyer konceptin e një opinioni që myslimanët janë të lidhur me turqit, duke dhënë një mesazh jo vetëm të harmonisë fetare, por edhe rolin që kanë luajtur myslimanët në çështje kombëtare. "Është thënë se myslimani shqiptarë është kundër reformave, kjo thjesht është një shpifje e ulët shpikur nga bullgarë, serbë dhe grekë dhe përsëritur nga disa shkrimtarë të kulturuar evropianë. Mund të them me bindje, se përveç disa fanatikëve, mys-

limani shqiptarë është më i zjarrtë për atdheun" Dhe do të vazhdonte se patriotë më aktivistë të Lidhjes së Prizrenit ishin Qemal beu, Abdyl bej Frashri, Mustafa aga, Dervish Mustafa efendi, Sheh -Ismail Efendi dhe myderriz Abdullah efendi, kurse Daut Myderriz efendi ishte në krye të Komitetit të Shkodrës. Ai shkruan se shpirti i Lidhjes Kombëtare ishin myslimanët shqiptarë.

**A ishte i njohur Gaspër Jakova Mërturi, në rrethin e historianëve, gjuhëtarëve dhe shkrimtarëve shqiptarë e veçanërisht shkodranë?**

I njohur ishte, por jo në thellësinë e dimensioneve të tij të gjithanshme që ai reflektoi dhe punoi sidomos jashtë vendit.

\*Në Fjalorin enciklopedik shqiptar, të vitit 2008 ka një zë me titull "Lajmëtar i Shqypënie", me autor Thanas Gjiken, ku tregohet për këtë revistë të përdyjavshme politike, shoqërore, kulturore, letrare,

shqip dhe italisht. që u drejtua nga, gjuhëtar, publicisti dhe historiani G. Jakova Mërturi, i cili shkruante me pseudonimin Conte Vladany

\*Prof. Jup Kastrati do ta përmendte në librat e tij "Histori e gramatologjisë shqiptare" botuar në Prishtinë më 1981 dhe "Gramatika e gjuhës shqipe", Tiranë, 1995, duke e paraqitur figurë interesante, ku do të shprehej: "Në radhë të parë ai qe një gjuhëtar i përgatitur për kohën, gramatolog, hartues rregullash drejtshkrimore dhe krijuesi i një alfabeti të shqipes".

\*Në Seminarin e IV Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", mbajtur në nëntor të vitit 2000, prof. Mimoza Priku, në bazë të studimit që kishte bërë prof. Jup Kastrati, për këtë gjuhëtar mban kumtesën "Konsideratë gjuhësore për dy gramatika të gjuhës shqipe-Gasper Jakova e Gasper Mikeli"

\*Hamdi Bushati e ka rreshtuar në



"Elitën Intelektuale të Shkodrës nga gjysma e dytë e shekullit XIX deri në dhjetëvjetëshin e II të shekullit XX", duke dhënë një biografi të këtij intelektualit erudit.

\*Luigi Gurakuqi, një figurë politike me peshë e dy dekadave të para të shekullit, studioi në Kolegjin Shën Adrianit të Shën Mitrit (San Demetrio Corone) dhe dha mësim të gjuhës shqipe. Ishte një bashkëkohës i tij që kishte vlerësime për këtë personalitet. Ai ka vlerësuar në poezitë e Gaspër Jakovës Mërturit ambicien e tij teknike Prof. Kolë Kamsi e përmend si mësues i gjuhë letërsisë në Kolegjin e Shën Adrianit, që dha mësim në vitin 1903-1904

\*Dr. Zenepe Dibra, në librin "Fjalor enciklopedik të hapësirës shkodrane", ka shkruar për biografinë e tij, mbështetur në disa burime.

Gaspër Jakova Mërturi vdiq në vitin 1941, duke lënë pas një trashëgimi me vlerë të madhe kulturore e historike. Ai si personalitet shumëdimensional, dha një kontribut në historiografi, në gjuhësi, folklor, gazetari, si mësimdhënës. Duke punuar si një zë i të vërtetës me një ndjenjë të thellë patriotike, me punën e tij të gjithanshme u përpoq të ndërkombëtarizonte çështjen shqiptare.

Libri i fundit i botuar dhe përkthyer nga zj. Fitije Picari, do të jetë një vlerë e shtuar në bibliotekat e Shkodrës për këtë personalitet me shumë dimensione. Prandaj ne e falënderojmë znj. Picari në mënyrë të veçantë për këtë punë me vlerë, me një ndjenjë përgjegjësie patriotike.

Përgatiti Dr. ZENEPE DIBRA

# Mesazh urimi, mësuesit e drejtuesit, poetit e shkrimtarit Mevlud Buci, në 75 vjetorin e lindjes së tij

(Shkrim profil në ditën e 7 Marsit)



Shkruar nga: FRAN GJOKA

Vitet ikin shpejt, duke lënë gjurmë të pashlyera në kujtesën tonë, breza që sakrifkuan shumë nga vetja për t'u dhënë dije e kulture brezave. Dhe vjen një ditë dhe del në pension. Sa më të thella të jenë njohjet, aq më të thella dhe të veçanta bëhen kujtimet. Por nuk janë vetëm vitet e punës ato që të bëjnë të vlerësuar dhe që të japin personalitet, janë veprat e mira, qëndrimi korrekt me njerëzit, mirëkuptimi dhe toleranca. Sa më shumë i njohim shokët e miqtë, veçanërisht në momente të vështira, aq më të thella janë dhe rrënjët e kujtesës. Nëse disa njerëz harrohen dhe kalojnë në jetën tonë si pa u ndierë, të tjerët mbeten të fiksuar fort në kujtesë dhe kështu bëhen të paharrueshëm. Kjo e dyta ndodh veçanërisht me njerëzit e punës, me ata që ndeshen me vështirësitë dhe u japin zgjidhje atyre, me ato që i shërbejnë drejtpërdrejt vlerave të jetës dhe qëllimeve të larta njerëzore. Do të ndalemi tek njëri prej atyre njerëzve të sakrificës, të përkushtimit, të vetmohimit dhe të pastërtisë morale. I tillë është portreti i Mevlud Bucit, figurë e njohur e gazetarisë, artistit pedagogjik dhe i letërsisë. Vjen në 75-vjetorin e tij të lindjes i nderuar e krenar. Jetë të gjatë dinjitoze burrit të vlerave e virtyeteve të larta njerëzore. Jemi njohur dekada të shkuara në redaksinë e gazetës "Mësuesi", gazetë me peshë në fushën e didaktikës dhe të edukimit, e cila vinte në lëvizje dhe nxiste dashuri ndaj mësimdhënies, çonte përpara vlerat e arsimit shqip, por tani ajo gazetë i mbetet kohës së shkuar, padrejtesisht ajo nuk ekziston më. Mevlud Hazi Buci u lind me 2 mars 1951, në Lukan (Kater Gryket - Selishtë - Diber). Ai ka mbaruar arsimin fillor në Kacni e Lukan dhe shkollën 7-vjeçare në Lunare të Kater Grykeve, me rezultate të shkëlqyera, pastaj shkollën pedagogjike "Luigj Gurakuqi" në Elbasan, fakultetin e mësuesisë me rezultate të larta, po ashtu të gjitha kategoritë e kualifikimit të mësuesisë. Në vitet 2011-2013, përfundon studimet pasuniversitare në fakultetin e

Shkencave Humane të Zotuara të Edukimit dhe mori gradën për Drejtim dhe Administrim në Arsim. Ka punuar 46 vite si mësues i gjuhës dhe letërsisë, si drejtor e nëndrejtor në shkollat, ndër më të mëdhatë e të vështira, në Diber e Tiranë. Përkatesisht në shkollat "Kadri Abdihoxha" Qafë Murre, Selishtë, "Kolë Jakova" si drejtor; në Lakanas, si zv. drejtor, në shkollat e mesme "Ataturk" e "Sander Prosi". Tiranë, si organizator e mësimdhënës në shkollat "Sadi Nuri" Yrshek e "Murat Toptani" në Tiranë. Mban titujt "Anëtar nderi i Diaspores", dhënë nga gazeta "Emigranti" dhe "Mësues i dalluar", dhënë nga Ministria e Arsimit. Mbi 50 vite ka shkruar në mjaft organe shtypi, lokale dhe qendrore, mban vlerësime në shtypin publik, ushtarak dhe nga revista shkencore. Ka shkruar me pseudonimin "Runja"; në revisten "Obelisk", "Humor shkodoran", "Kunji", "Mësuesi", "Humor e satirë", "Urtësia", "Gjuha jonë", "Emathia", "Arsimi sot dhe nesër", "Rreth e rrotull" etj. Është një bashkëpunëtor i rregullt i gazetës "Rruga e Arberit", me fokus shkrimet mbi traditën dhe etnokulturën. Për shume vite ka qenë bashkëpunëtor i Radio Kukësit, Radio Tiranës, bashkëpunëtor shkencor i Akademisë së Shkencave (Instituti i Folklorit).

Mevlud Buci është stërnip i Hoxhë Bucit (Mulla Bajram Bucit), i cili ishte Sekretar i Lidhjes së Prizrenit për Dibrën, shok i Iliaz Pashë Dibres, zotërues i 7 gjuhëve të huaja. Me babanë e me të birin, Hoxhë Buci u vra për atdhe në shtator 1913, me të birin Mustafanë e Hoxhë Bodinin, në malin e Petrinos (Petrino) në mësymjen e dytë kundër serbve. Kulla e Bucit historikisht ishte bazë e patriotëve të Dibrës e më gjerë. Xhaxhai, Bajram Buci (i Riu) ishte luftëtar i lirisë qysh në njësitin e parë të çetës së Dibrës; shtëpia ishte bazë e luftëtarëve të lirisë të Dibrës, Matit e më gjërë. Mevlud Buci është nip i kullës atdhetare të Manukëve të Luznisë: Hazi e Demir Manuka, burrave të shquar e mentarë: Rrem, Destan, Naim, Sakip, Fetah, Maliq, Seit, Gani, Veli dhe Naim Manuka. Më 1920, dajat qëndrestarë e shndërruan kullën në kala qëndrestarë ku, në rrethim, u vra edhe komandanti serb, gjeneral, - thotë muza popullore. Babai i tij, Hazi Buci, ishte njeri i vlerave, i njohur në krahinën e Dibrës për fjalën e tij bindëse dhe të sinqertë. Ai i fton bashkëfshatarët e vet dhe të krahinës për bashkëpunim, unitet dhe pajtim. Toleranca dhe bashkëjetesa ishin për Hazi Bucin, tipari dallues, që e bënte të rrezatonte mirësi e dashuri tek miqtë dhe shokët e shumtë të tij, me të cilët punonte e ndante të mirën me fatkeqësinë njerëzore. I priste dhe i përcillte njerëzit si vëllezër dhe shokë në shtëpinë

e tij. Sa jetoi, kurrë nuk bëri kompromis me karakterin e tij. Mbeti deri në frymëmarrjen e fundit i dashur me të vërtetën dhe i rreptë me padrejtësitë. Fëmijëria dhe adoleshenca nuk ishin të lehta për të e ndaj ky është shkaku i një miredukimi e shkollimi me sakrificë, të cilat ai ka ditur t'i mundë shumë mirë. Ishin pikënisjet librat që lexonte, që e bënë të shtonte dhe mundësinë e shprehjes në komunikimet me njerëzit. Që në rininë e hershme të tij, Mevludi veçohej si një djalë fjalëpak, pa zhurmë dhe me energji të pashtershme, dashamirës që nuk iu dëgjua kurrë zëri për keq, gojëmbël, kurajoz që mbron me dinjitet pikëpamjet e tij. Shumë shpejt u shndërrua një ndër figurat e dashura publike jo vetëm për Dibrën dhe Tiranën, por në tërë Shqipërinë. Duke qenë një burrë malësor me tradita të shkëlqyera fisnikë, trashëgoi e përcolli për 50 vjet tek brezat e rinj mesazhin e një kulture të ngritur dhe profesionalizmi të spikatur. Tek Mevlud Buci mendimi dhe prokupimi i vazhdueshëm qëndron përherë zgjuar, ashtu siç rrinë ndezur në një vatër të ngrohtë familjare, ëndërron aspiratën e shpejtë dhe rrugën për një demokraci të vërtetë dhe integrim dinjitoz dhe të natyrshëm evropian. Ndërsa bashkëshortja e tij, Shahe Buci, dhe pse ka vite që ka dalë në pension, ajo punon dhe shërben me devotshmëri familjes së saj. Cilësitë e vjera, edukatën dhe kulturën e lartë, Shahja e përcolli te shtatë djemtë dhe vajzat e saj, teksa shfaq një dobësi të veçantë për trembëdhjetë nipërit dhe mbesat e saj. Për Shahen dhe familjen janë ëmbëlsira e shpirtit. Këta shtatë pasardhës shikojnë sot te prindërit e tyre modelin e prindërve të devotshëm, babain e tyre të mirënjohur e shembullor në gjithçka, të nënës së tyre, që personifikon modelin, figurën e një nëne të dhembshur, të dashur dhe me dijeni të shumta për jetën. Një nënë, një zonjë e shkëlqyer, një bashkëshorte model, një qytetare me emancipim bashkëkohor. Mësuesi dhe drejtuesi, poeti dhe shkrimtari i talentuar i "Katër Grykëve", Diber vazhdoi të shkruajë me pasion, ku trajtonte me vërtetësi problemet e arsimit. Sot, në 75-vjetorin e lindjes, Mevludi është ende energjik, pasionant dhe i shkathët, një studiues dhe intelektual i mirë që rrezaton vlera të rralla dhe talent të spikatur. E shikoj me respekt, flasin shpesh e me përzemërsi dhe gjithnjë më sjell ndërmend natyrën e tij fisnike të njeriut me zemër të madhe dhe me shpirt të gjerë. Te karakteri i tij burrëror mund të shikosh një shpirt tepër human dhe një vendimmarrës për t'i dhënë zgjidhjen e duhur në momentin e duhur problemeve të drejtimit dhe menaxhimit me efikasitet të arsimit. Mevludi i gëzohet aftësive të tij,

përpjekjeve, munitit dhe djersës, sakrificave dhe dinjitetit. Skalisti dhe portretizoi figurën e një mësuesi, drejtuesi, gazetari dhe shkrimtari të afirmuar. Është botues i 29 librave dhe pesë librave të tjerë që shumë shpejt presin dritën e botimit. Një fjalë e urtë thotë: "Duhet hedhur hapi i parë, që të nisesh rrugën drejt shtigjeve të reja krijimtarië".

1. "Krushqia e korbit", libër me satira, epigrame, epitafe, 1997.
2. "Udha e mirësisë", libër me poezi lirike - filozofike, 1998.
3. "Metafora e Shpirtit", libër me një mijë aforizma të krijuara, 2000.
4. "Thirrje njerëzore", libër liriko-epik, poezi, 2001.
5. "Drita hyjnore", libër publicistikoletrar me 12 kapituj, 2002.
6. "Krushqia e korbit", ribotim me shtesa, fabula, satira, epigrame, 2002.
7. "Foleja e shqiponjës", libër poetik për fëmijë, 2003.
8. "Koha thërret", libër satirik, fabula, satira, aforizma, 2003.
9. "Fletorja e artë e Sander Prosit", libër publicistikoletrar, 2004.
10. "Ylberë mençurie", libër me 1030 aforizma filozofike të krijuara nga vetë autori, 2005.
11. "Selim Brahja i Saukut-shenjtor i lirisë", libër publicistikoletrar, 2005.
12. "Metafora e shpirtit", libër me 1500 aforizma të krijuara, ribotim me shtesa, 2005.
13. "Diplomat diplomacia", libër satirik me 21 poema, 2005.
14. "Dritare fisnikërie", libër publicistikoletrar për vlerat e figurat arsimore dibrane dhe mbarëkombëtare, 2007.
15. "Fjalor me shprehje dhe njësi frazeologjike nga Dibra", 2008.
16. "Prova shenjtërie", libër publicistikoletrar për shenjtërimin njerëzor për Buzemadhen e shenjtë, 2008.
17. "Myftinia e Dibrës dhe magjistër Ruzhdi Lata", libër studimor, 2008.
18. "Bukuria e universit të besimit", libër studimor, 2008, me 1015 aforizma të krijuara për dritën e besimit, vëllazërimin fetar.
19. "Alegoria e Luznisë dhe gjuha e zogjve", libër monografik me studime publicistikeletrare, krijimtari e hulumtime, 2010.
20. "Një jetë në pavdekësi", libër publicistikoletrar për martirin e demokracisë, Mark Tom Rozhani, me shtatë kapituj, 2012.
21. "Qëndrestarët e flamurit", libër studimor me 5 kapituj, për figurat kombëtare-atdhetare., 2012.
22. "Udhët e fisnikërisë", libër publicistikoletrar, për figura t ndritura të fis-

- nikërisë, të punës, arsimit e kulturës, 2013.
23. "Alegoria e Dibrës, filozofi e shekujve", (Gjurmime alegorike, anekdota, shprehje popullore), ribotim, 2014.
  24. "Dritë jete, dritë vlerash", libër publicistiko-letrar me shkrime, skica, krijime për vlerat njerëzore.
  25. "Qesh e qaj me lot", libër me poezi satirike, fabula, aforizma satirike, tregime.
  26. "Mexhit Capa dhe krahët e fisit", libër publicistik-letrar me 10 kapituj, 2020.
  27. "Shenjtëria", libër liriko-epik, poezi me një pjesë të krijimtarisë në 50 vite të botuara në shtypin letrar (2020).
  28. "Hoxhë Buci i Dibrës dritëshenjtëria për mëmëdhenë" (Libër monografik) 2021.
  29. "Alegoria e Dibrës, filozofi e shekujve", (Gjurmime alegorike, anekdota, shprehje popullore), ribotim, 2022.

Përfshirja në këtë veprimtari krijuese 50-vjeçare ishte për Mevlud Bucin një përvojë e bukur dhe interesante, pasi kështu u njoh me shumë njerëz të ndryshëm dijetarë, shkrimtarë, shkencëtarë, por dhe me shumë njerëz të thjeshtë, të cilët e respektonin dhe i hapnin derën e shtëpisë në çdo kohë. Ai sot është i vetëdijshëm kur thotë se çdo studim apo kërkim shkencor, kur kryhet jashtë kohës së procesit mësimor, është investim për të ardhmen. Kur vitet kalojnë dhe del në pension, secili e ndien sa vlen dhe sa çmohet në mjediset akademike dhe në shoqërinë krijuese. Studiuesi Mevlud Buci, në ato qindra shkrime të tij shpreh shpesh dhe paaftësinë e disa mësuesve për shkak të nivelit të ulët profesional, është një nga faktorët më me rëndësi, por dhe degjenerimi i teksteve mësimore ka bërë të veten. Ai këshillon gjithnjë institucionet arsimore që t'i kushtojnë më shumë vëmendje arsimit kombëtar dhe në veçanti investim arsimit të fëmijëve. Mevlud Buci i Dibrës dhe i gjithë Shqipërisë nuk pushon së shkruari. Me sa duket është ngacmuar nga thënia e Sami Frashrit: "Njeriu nuk është i përjetshëm, le të përpiqet të jetë e pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë". Një jetë e tërë në mësuesi dhe krijimtari është mbushur sot me shumë synime e vlerësime të merituar. Në shtator 1986 i jepet titulli "Mësues i dalluar" për interpretim pedagogjik të problemeve të arsimit. Në vitin 1984 dhe 1988 i jepen dy medalje "Naim Frasheri" të klasit të dytë dhe të tretë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të asaj kohe. Në janar 2004 "Çertifikatë Mirënjohjeje" shkolla, media dhe të drejtat e njeriut. Mevlud Bucit i jepet Çmimi i dytë për poemën "Epika e Koliçit", në konkursin "Krijimtaria Dibrane 2007". Po në vitet 2008 dhe 2009 për librin më të mirë në fushën shkencës, kulturës dhe artit islam. Më 30 tetor 2019, nderohet me "Mirënjohje" nga shkolla 9-vjeçare Vranjt, e Kastriotit të Dibrës për arritje në mësimdhënie dhe për botimin e librave të tij. Me motivacionin "Për kontribut të veçantë në mësimdhënie dhe nxënësve". Krijimtaria juaj është një dritare më shumë për të ardhmen tonë". Më 12 shtator 2020 ka marrë "Çmimin e Karrierës" në konkursin "Muza Budiane 5" (organizuar në shkallë mbarëkombëtare). 15 nëntor 2020, nderohet me Mirënjohje



hje për poezinë e botuar në antologjinë poetike "Na bashkoi poezia 7". 16 shkurt 2021 vlerësohet me titullin e lartë "Nderi i Shoqatës BPVPSH" me këtë motivacion: "Për bashkëpunimin efektiv me kryesinë e shoqatës BPVPSH, si zëvendëskryeredaktor i gazetës "Zëri i të moshuarve" dhe si botues i 30 librave në prozë, poezi e satirë". Po në vitin 2023 i jepet Çmimi i Tretë "Muza Poetike Budiane". Në vitin 2024 i jepet Çertifikatë Mirënjohjeje dhënë në festivalin e tetë kombëtar "Muza Poetike Budiane". Në 29 librat e tij lexohet sharmi i atdhedashurisë dhe i lirizmit më të lartë, realitetit më të mrekullueshëm, aq i lexuar dhe në të njëjtën kohë dhe modest. Mbetet një studiues aktiv, nuk lodhet kurë nga hulumtimet dhe kërkimet shkencore, duke treguar mesazhin e një kulture të ngritur dhe profesionalizmi të spikatur. Gjatë bisedës me Mevludin vazhdon të ketë ende një merak që s'i jepet ende titulli "Mirënjohje e Qarkut të Dibrës". Ndaj ky institucion duhet t'i akordojë njëzëri këtë titull të premtuar kohë më parë, se ai nuk i përket vetëm Dibrës, por tërë Shqipërisë.

Vetëm kështu do të gjejë zbatim ajo thënia e dramaturgut nobelist, H. Pitersen: "E vërteta është e kapshme, kërkimi i së vërtetës është detyrim". I shqetësuar mbetet Mevludi kur thotë se ne nuk duhet të lejojmë të papërgjegjshmen e qeveritarëve të sotëm, si ato të ikjes masive të rinjve nga vendi në këto dhjetë vitet e fundit, por duhet të krijojmë me çdo kusht kondita të favorshme në këtë drejtim. Duhet të ngrihem me forcën e dinjitetit kombëtar, patriotik dhe intelektual që t'i pritët rruga kësaj të keqja të madhe, e cila ka marrë përmasat e një sëmundje galopante. Në këtë vend sa të bukur, aq dhe të pasur, ka vend për të gjithë që të jetojmë mirë". Sot Mevlud Buci u gëzohet aftësive të tij krijuese dhe hulumtuese të tij, përpjekjeve, mundit dhe djersës, sakrificave dhe dinjitetit. Skaliti dhe portretizoi figurën e një personaliteti me vlera të mëdha intelektuale. Duke biseduar me këtë mësues pensionist, të duket se dëgjon zëra brezash në vite tek rrëfejnë se mësues Mevludi ka bërë ç'është e mundur të kryejë më së miri detyrën e mësuesit dhe

drejtuesit të vërtetë. Shërbeu për 50 vjet drejtues shkolle në Dibër e në disa shkolla të mesme të Tiranës, duke mos kursyer asgjë nga vetja, duke i dhënë nga shpirti i tij i madh e bujar gjithçka për nxënësit, rrezatoi kudo kulturë dhe me plot pasion u dha dije e kulturë brezave. Një jetë e tërë në mësuesi, gazetari dhe krijimtari letrare është mbushur sot me shumë synime e vlerësime të merituar. Mevlud Buci është dhe mbetet një burrë ideal, një shkrimtar i gjerë miqësie e shoqërie nga të gjitha trevat shqiptare, duke skalitur me atë portretin e një malësori të vërtetë dibran dhe krenar që rrezaton vetëm mirësi dhe frymë atdhedashurie. Një prind që u gëzohet fëmijëve të tij, një gjysh ku reflekton përkujdesje dhe dashuri atërore për nipërit dhe mbesat. Unë, si shok dhe mik i tij, i uroj në 75-vjetorin e lindjes së tij shëndet dhe jetë të gjatë bashkëshortore! Kudo ti mbetesh përherë i nderuar e krenar, si një zë intelektual të përkushtuar dhe me integritet të lartë njerëzor.

# Mosmirënjohja, turpi ynë i heshtur!



Prof. Dr. LULJETA PULA,  
politikane e shkrimtare nga Prishtina

Ka diçka që rëndon shumë mbi ndërgjegjen tonë kolektive, është kjo harresa. Kjo nuk është harresë e zakonshme. Është më shumë se kaq! Është një neglizhencë, një shpërfillje, një injorim, një mosmirënjohje ndaj atyre që na ndihmuan të mbijetojmë si komb edhe atëherë kur të tjerët nuk çanë kokën për ne!

Si mund të harrohet ndihma fisnike, bujare dhe e përkushtuar e pedagogëve nga Tirana, Universitetit tone të porsalindur të Prishtinës në vitet e 70-tat, kur ne vuanim për kuadro në gjuhën shqipe dhe kur alternativa ishte, Beogradi dhe mësimi në serbisht, i studentëve tanë.

Në këtë errësirë erdhi drita! Dhe drita erdhi nga Shqipëria mëmë! Dhjetëra pedagogë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, pedagogë të jashtëzakonshëm, të ngritur intelektualisht, të jashtëzakonshëm profesionalisht në fushat e tyre, brilante si pedagogë, të afërt e dashamirës si me studentët ashtu edhe me kolegët, erdhën në Kosovë për ta mëkëmbur Universitetin e sapolindur të Prishtinës. Ata mbollën farën e dijes, e cila më pas do të bëhet shtyllë e rezistencës sonë për liri. Nga ato

auditorë, dolën njerëzit, që më pas do të ishin në ballë të rezistencës politike, kulturore dhe kombëtare të viteve 80 dhe 90.

Në shumë fakultete të Universitetit të Prishtinës, lëndët kryesore, profesionale dhe fundamentale i mbanin profesorë nga Tirana. Kishte fakultete, siç ishte Fakulteti i Gjeologjisë, në Mitrovicë, i cili mbahej në këmbë vetëm e vetëm me profesorë nga Tirana. Deri më 1981 kur pushteti serb, me urdhër politik ndaloi ardhjen e profesorëve nga Shqipëria në Kosovë! Dhe atëherë, pikërisht atëherë, Universiteti ynë ndjeu peshën e braktisjes dhe dhembjen e humbjes, sepse atëherë, studentët duhet të dëgjonin mësimin në serbisht!

Askush gjer më sot, nuk e pa të arsyeshme ti thoshin një faleminderit Shqipërisë, për këtë ndihmë të përkushtuar, të veçantë e të jashtëzakonshme në nivelet më të larta shkencore e pedagogjike, të krahasueshme me universitetet më të dëgjura qindrvjeçare të Evropës, dhe të shprehë qoftë edhe një mirënjohje verbale për ndihmën, e lëre më institucionale për këtë ndihmë të pakursyer në kohërat tona më të vështira. Nuk e bënë këtë as organet legale të Universitetit asnjëherë në këto 50 vjet, nuk e bënë as institucionet politike dhe as shtetërore të Kosovës, as para e as pas luftës.

E mosmirënjohja nuk është mungesë falënderimi. Mosmirënjohja është një varfëri e thellë shpirtërore, sepse një popull që nuk di të nderojë ata që e ndihmuan në kohët më të vështira, ai humbet busullën morale! Nuk duhet një diçka e madhe! Mjafton të thuhet e vërteta dhe të ngjallet kujtesa! Sepse Shqipëria ishte aty, kur ne kishim më së shumti nevojë!

Dhe unë dua të them tani, se ka një të vërtetë që nuk thuhet me zë! Pa Shqipërinë, edhe rruga e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë së saj, do të ishte edhe më e gjatë, edhe më e dhimbshme, ndoshta edhe e pamundur!

Por kjo e vërtetë sot nuk ka vend në institucionet tona.

bashkësinë tonë dhe marrëdhëniet mes dy vendeve!"

Është e çuditshme, por pak shqiptare e dine ose nuk janë të informuar se Belgjike si kryeqytet i Evropës nuk ka Ambasade në Tiranë! Asnjëherë nuk kishte interes për Shqipërinë! Asnjë qeveri, që nga Ismail Qemali në vitin 1912 e më vonë Princ Vidi, Regjimi i Zogut, Regjimi Komunist e Post Komunist nuk arritën të bindnin qeverinë Belge, që të kenë një Ambasade në Tiranë.

Në Nëntor të vitit 1971, Belgjika e Shqipëria vendosen marrëdhënie mes tyre. Belgjika caktoi ambasadorin e saj në Beograd. Pas viteve 80', Shqipëria do të mbulohej nga ambasada Belge, në Romë dhe në vitet e fundit në Bullgari.

Në mes dy vendeve tona nuk ka pasur marrëdhënie ekonomike e tregtare përveç delegacioneve të Komunistëve të Belgjikës. E njëjta situatë është ende për shtetasit shqiptar, të cilët kane siguruar një kontratë pune e janë të detyruar të shkojnë

A duhet përmendur tani se para luftës kur Kosova rronte nën shtypjen e egër të regjimit serb, ishte Shqipëria. Pra, ishte ajo që lobonte anekënd globit, si shtet e në mënyrë institucionale për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Në kancelaritë më të fuqishme të globit. Ishte Shqipëria pra, ajo që ngrite zërin në forume, në institucione shtetërore në botë, në organizma ndërkombëtarë të drejtave të njeriut, në Konferenca të ndryshme ndërkombëtare, dhe në zyrat më të fuqishme diplomatike të botës, duke argumentuar me fakte se Kosovës i takon e drejta e vetëvendosjes edhe pse vet në rrethana tranzicioni. Ishte Shqipëria, dhe askush tjetër, ajo që e mbajti gjallë çështjen e Kosovës, natyrisht së bashku me Lëvizjen politike të Kosovës, sepse Kosova, rrezikonte të mbetej çështje e brendshme e Jugosllavisë dhe Serbisë. Shqipëria ishte shtet dhe fjala e shtetit ka një tjetër peshë.

A duhet përmendur tani se stërvitjen e luftëtarëve tanë të lirisë e bëri Shqipëria. Në mënyrë gjysmë legale apo edhe jo legale. Armët për luftën e UÇK—së na i siguroi Shqipëria dhe se shumë luftëtarë nga Shqipëria iu bashkuan UÇK-së, dhe ranë në mbrojtje të lirisë së Kosovës.

A duhet përmendur tani, atë më të rëndën, pra luftën në Kosovë, kur mbi gjysmë milioni shqiptarë u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre. Ishte Shqipëria ajo, e cila i bëri konak popullit të sflitur të Kosovës. Ishte Shqipëria pra, ajo e cila hapi vatrat e saj, hapi zemrën dhe shpirtin vëllazëror e të gjakut! Në varfërinë dhe mjerimin e saj, ishte ajo që strehoi qindra mijëra shqiptarë me bujari, mikpritje dhe fisnikëri të pashoqe! Dhe si mund të harrohet kjo? Si mund të heshtet kjo sakrificë sublime e Shqipërisë dhe popullit të saj?

Pra, si është e mundur që institucioneve tona, asnjëherë nuk u shkoi ndërmend të bëjnë një falënderim publik e të shprehin një mirënjohje të thellë në emër të popullit të vuajtur të Kosovës?

Si është e mundur që Presidenca e

Kosovës, që dekoron kë bën e kë s' bën, të mos kujtohet të dekorojë me Urdhrin dhe Medaljen Presidenciale për Merita të Jashtëzakonshme, Presidentin e atëherëshëm të Shqipërisë, Akademik Rexhep Meidanin, për kontribut të jashtëzakonshëm në kohën e luftës, për strehimin e qindra mijëra refugjatëve?

Dhe natyrisht, së fundmi, duhet përmendur sigurisht, edhe mbështetjen konsistence dhe të vijueshme të Shqipërisë, dhe lobimin e saj për mbarimin e duhur të shtet ndërtimit të Kosovës, në të gjitha kancelaritë botërore, në të gjitha zyrat diplomatike, për lobimin e saj të palëkundur për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare përfshirë OKB-në, për koordinimin rajonal dhe për vetë procesin e njohjeve ndërkombëtare, në takime bilaterale dhe multilaterale në tërë botën.

Shqipëria është shtet! Dhe ky është fati ynë! Fati, që nuk ditëm ta vlerësojmë si duhet e sa duhet! Dhe sepse Shqipëria u bë zëri ynë, atëherë kur zëri ynë nuk mjaftonte!

Dhe sot heshtje institucionale! Abstinencë e rëndë mirënjohjeje institucionale.

Dhe kjo nuk është thjesht harresë. Është më shumë se kaq! Është deformim i kujtesës historike!

Dhe në fund dua të them se s' bën! Mosmirënjohja nuk e zvogëlon madhësinë e të bërit.

Mosmirënjohja, na bën ne të vegjël dhe shpirtngushtë!

Sepse mosmirënjohja rrezikon të na humbë sensin e drejtësisë dhe së vërtetës!

Shqipëria nuk është fqinji ynë! Ajo është mbështetja ynë, ajo është streha jonë, ajo është krahu jonë, ajo është zëri ynë që nuk ndaloi asnjëherë!

në Bullgari, për të marre vizë për punë. Një përpjekje e mundimshme për takim, shpenzime, për udhëtim e fjetje.

Atdhetari Adnan Rexhepi, i ardhur emigrant nga Kosova e tashme drejtues i Shoqatës "Nënë Tereza", ka punuar në ekipin e komunës Namur, me Maxim Prévot, drejtues sot i Ministrisë së Jashtme Federale në Belgjike. Sot bashkësia shqiptarë në Belgjike, është rritur në 70 mijë banorë rezidente. Emigranti i pare shqiptar në Belgjike është Sul Rroi, bir i një familje të nderuar të Shkodrës.

Vendosja e Ambasadës së Belgjikës do të bënte, që shqiptaret të kenë më shumë kontakte me Belgjikën në nivelin ekonomik e kulturor.

Hapja e Ambasadës do të sjelle shumë mundësi komunikimi për të gjithë Shqiptaret.

Përgatiti: ZEF NIKA,  
Bruksel



## Ambasada e Belgjikës në Tiranë

Ambasada e Belgjikës në Tiranë do të hapet shumë shpejt. Një hap ky shumë i rëndësishëm për bashkësinë e shqiptareve dhe marrëdhënieve mes dy vendeve.

Adnan Rexhepi, kryetari i shoqatës "Nënë Tereza", në Namurin, Belgjike, në një postim në rrjetin social deklaroi:

"Jam shumë krenar për punën e madhe dhe të pandalshme që kam bërë ndër vite me bashkësinë tonë. Sot dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për mikun tim të çmuar Maxim Prévot, i cili ka dhënë mbështetje të jashtëzakonshme. Falë këtij bashkëpunimi dhe përpjekjeve tona, Ambasada e Belgjikës në Tiranë do të hapet shumë shpejt, një hap i rëndësishëm për


# Tropojani fisnik, Ibrahim Ukë Hajdarmataj

Ibrahim Ukë Hajdarmataj është nga ata burra që Malësia i rrit ngadalë, me gurin, me erën dhe me heshtjen e mençur të maleve. I lindur në pranverën e vitit 1947, në fshatin Zogaj të Malësisë së Gjakovës, ai mbart në qenien e tij një fisnikëri të trashëguar, që nuk shfaqet me zhurmë, por me qëndrim, me fjalë të matur dhe me vepra të pastra. Tropoja, vend i karaktereve të forta dhe i burrnisë së heshtur, gjeti tek ai një përfaqësues të denjë të shpirtit të saj. Rruga e dijes për të nisi në vendlindje, vijoi në Kukës dhe u përmyll në qytetin që mban emrin e një heroi, Bajram Curri.

Më pas, Shkodra i dha formimin pedagogjik në shkollën "Shejnaze Juka", ndërsa Tirana i hapi horizontin universitar në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë, ku dashuria për fjalën, librin dhe mendimin kritik u bë pjesë e pandarë e personalitetit të tij. Edhe pas diplomimit, ai nuk u ndal; specializimi në Letërsi ishte dëshmi e një etjeje të vazhdueshme për kulturë dhe për thellim shpirtëror. Pothuajse gjithë jetën ia kushtoi vendlindjes. Mësues, zëvendësredaktor e drejtor gjimnazi, drejtor i Shtëpisë së Kulturës, shef kuadri, kryetar i Këshillit Popullor të fshatit të bashkuar Zogaj, në çdo detyrë la gjurmën e një shërbëtori të ndershëm të komunitetit. Asnjëherë pushteti nuk e tundoi, asnjëherë pozita nuk ia errësoi gjykimin. Ai nuk i mati njerëzit me miqësi, interes apo përkatësi, por me dinjitetin e tyre njerëzor, duke ruajtur gjithmonë një standard moral që sot është i rrallë. Të bisedosh me Ibrahim Ukë Hajdarmatajn është një përvojë qetësuese. Ai nuk ta ndërpret fjalën, të dëgjon me durim dhe të jep kurajë të flasësh. Kur vjen radha e tij, flet thjeshtë, me qartësi dhe me një logjikë të pastër, që buron nga përvoja dhe jo nga pretendimi. Edhe në moshë, ai ruan sinqeritetin dhe pastërtinë shpirtërore, një qëndrim fisnik që e bën të respektueshëm në çdo rreth. Edhe sot, pensionist, ai jeton e punon në vendlindje si fermer, duke i shërbyer familjes me të njëjtën devotshmëri që dikur i shërbeu arsimit dhe kulturës. Jetëshkrimi i tij është e pasur jo vetëm me tituj e funksione, por mbi të gjitha me vlera njerëzore, me modesti dhe me një ngazëllim të brendshëm që nuk shtron. Takimet e rastësishme në Croydon të Londrës, veçanërisht kur biseda ndalej te plagët dhe shpresat e tranzicionit të gjatë shqiptar, e zbulojnë edhe më qartë figurën e tij: i hapur, me vështrim të ëmbël e respektues, i gatshëm të debatojë me pasion, argument dhe vizion për alternativa më të shëndosha demokratike.

I ngritur në dinjitet, parimor dhe i pastër nga çdo dukuri negative, Ibrahim Ukë Hajdarmataj është dhe mbetet një patriot i heshtur, një shok e mik i çmuar, një shqiptar ideal dhe një familjar i shkëlqy-

er – një tropojan fisnik në kuptimin më të plotë të fjalës. Ai nuk e kërkon vëmendjen dhe as nuk e shpall veten shembull; pikërisht për këtë arsye bëhet i tillë. Fisnikëria e tij nuk është dekor, por mënyrë jetese. Në çdo rrethanë, Ibrahim Ukë Hajdarmataj e ka ruajtur ekuilibrin mes arsyes dhe ndjenjës, mes ligjërimit të drejtë dhe dhembshurisë njerëzore. Te ai nuk gjen ashpërsi hakmarrëse, por as lëshime parimore; gjen vetëm drejtësi të qetë dhe bindjen se njeriu vlen aq sa fjala dhe vepra e tij. Në Tropojë, emri i tij përmen-det me respekt, sepse lidhet me shkollën, me librin, me kulturën dhe me punën e ndershme. Ai është nga ata mësues që nuk u larguan nga nxënësit as kur koha u vështirësua, nga ata drejtues që nuk u shkëputën nga njerëzit as kur drejtimi u bë barrë. Në shtëpinë e kulturës, në shkollë apo në administrim, ai ishte gjithnjë i njëjti: i hapur, korrekt, i matur, duke e parë shërbimin publik si mision dhe jo si privilegj. Në jetën familjare, Ibrahim është shtyllë e qetë dhe e besueshme. Ai e kupton familjen si vazhdimësi vlerash, si strehë morali dhe si shkollë të parë të qytetarisë. Kujdesi për të afërmit, respekti për traditën dhe hapja ndaj brezave të rinj



janë pjesë e natyrshme e përditshmërisë së tij. Edhe puna si fermer nuk është për të thjesht mjet jetese, por një lidhje e drejtpërdrejtë me tokën, me rrënjët dhe me dinjitetin e punës së ndershme. Në një kohë kur zhurma shpesh mbulon vlerën dhe shfaqja zë vendin e përmbajtjes, figura e Ibrahim Ukë Hajdarmatajt vjen si kujtesë e nevojshme. Ai dëshmon se mund të jesh i ditur pa qenë arrogant, drejtues

pa qenë i ftohtë, patriot pa qenë retorik. Ai mbetet një njeri i fjalës së mbajtur, i punës së bërë në heshtje dhe i besimit se Shqipëria ka nevojë për më shumë njerëz si ai: të thjeshtë, të drejtë dhe thellësisht njerëzorë. Kështu, portreti i tij nuk mbyllet me një datë apo me një funksion, por mbetet i hapur, si një rrugë malore që të çon lart pa zhurmë. Ibrahim Ukë Hajdarmataj është një dëshmi e gjallë se fisnikëria nuk është titull, por karakter, dhe se Tropoja, përmes bijve të saj më të mirë, vazhdon të flasë me zë të qetë e të qëndrueshëm në historinë njerëzore të këtij vendi. Dhe pikërisht në këtë qetësi që e shoqëron, ai bëhet i fortë.

Forca e Ibrahim Ukë Hajdarmatajt nuk buron nga imponimi, por nga besueshmëria; jo nga zëri i ngritur, por nga qëndrimi i drejtë. Ai është nga ata njerëz që, pa e thënë, të mësojnë si duhet të sillesh, si duhet të dëgjosh dhe si duhet të

mendosh për të mirën e përbashkët. Prania e tij nuk rëndon, por ndriçon, sepse mbështetet në një etikë të brendshme që nuk lëkundet nga stinët politike apo nga interesat kalimtare. Në bisedat për Shqipërinë, sidomos për plagët e tranzicionit të zgjatur, ai nuk bie në ankim as në nostalgji boshe. Analiza e tij është e kthjellët, e matur dhe e orientuar drejt zgjidhjes. Ai flet për demokracinë jo si slogan, por si kulturë sjelljeje; për lirinë jo si privilegj, por si përgjegjësi; për shtetin jo si pronë, por si shërbim. Në këtë kuptim, mendimi i tij është një thesar i heshtur, që do të vrente të dëgjohej më shumë, sidomos nga brezat që kërkojnë modele të besueshme. Brezi i tij, shpesh i lodhur nga tranzicionet e njëpasnjëshme, tek Ibrahim gjen një përfaqësues dinjitoz: njeri që ka kaluar sisteme, por nuk ka humbur busullën morale; që ka njohur pushtet, por nuk është bërë rob i tij; që ka përjetuar vështirësi, por nuk është bërë i ashpër. Ky ekuilibër e bën figurën e tij të rrallë dhe të çmuar. Në fund, Ibrahim Ukë Hajdarmataj mbetet një dëshmi e gjallë se atdheu nuk mbahet vetëm nga figurat e mëdha të historisë, por edhe nga njerëzit e zakonshëm me jetë të jashtëzakonshme në ndershmëri. Ai është një nga ata gurë themeli që nuk duken, por pa të cilët shtëpia do të lëkundej.

Një tropojan fisnik, që me jetën e tij ka shkruar pa bujë një mësim të madh: se dinjiteti personal është forma më e lartë e patriotizmit.

## HUMB JETËN NJË NDER PIONIERËT E PARE TË ELEKTRICISTËVE TË SHLLAKUT, MARK LISI.

Një lajm mjaft i trishtë për të gjithë krahinën e Shllakut, është ndarja nga jeta e elektrikistit Mark Ndue Lisi nga fshati Kroni i Madh. Ishte një nder pionierët e pare të elektrikistëve të Shllakut. Ishte duke riparuar një defekt në linjën elektrike në Shkodër, ku u rrezuar nga shtylla e për pasoj gjeti dhe vdekjen e menjëhershme.

Mark Ndue Lisi lindi me 18.05.1955, në fshatit Kroni i Madh. Që në moshë të re u angazhua në linjën telefonike e më vonë punoi elektrikist. Marku ishte nder të parët elektrikistë të krahinës së Shllakut. Ai ishte specializua në Shkollën Profesionale në Tirane për elektoturbini.

U dallua për aftësitë e larta profesionale në të gjithë Ndërmarrjen Elektrike Shkodër. Duke parë vështirësitë e transportit të transformatorëve nëpër fshatra të Shllakut, ai arriti të bëjë vete bobinat elektrike e duke riparuar transformatorët, sfidoi Ndërmarrjen Elektrike dhe ndihmoi banoret në çdo fshat. Kudo që kishte një defekt thirrej Mark Lisi.

Për Shllaksit u bë mjaft i njohur me komunikimin e me butësinë e tij. Nuk do të harrojmë organizimin e fshatrave në transportimin e transformatorëve, duke mbajtur linjat Elektrike në funksion nga dëmtimet e mëdha atmosferike. Marku do mbahet mend për bujarinë e ndershmërinë e tij si një burrë shembullor për familjen e krahinën e Shllakut. Ai la respekt në kujtesën e njerëzve, që do të kujtohet gjate!

Shprehim ngushëllimet e thella familjes e të afërmeve kudo që ndodhen!  
Pushosh në paqe Maek Lisi!

ZEF NIKA, NDOC PRENDUSHI



FATMIR TERZIU

# Një ngjarje në tokë dhe jo vetëm kaq

(RECENSION PËR ROMANIN ME TË NJËJTIN TITULL TË IPESHKVIT IMZOT ZEF SIMONI)

## Një titull sugjestiv...

Nuk më është dashur shumë të shtyhem me një dëshirë të fortë për të lexuar librin "Ngjarje në tokë". Menjëherë, sapo kam shikuar titullin e veprës dhe emrin e autorit, diçka misterioze më goditi në shpirt. Më foli shumë ky titull, para se ta lexoja librin! Ndoshta se unë e njihja Imzot Zef Simonin që në 1991 dhe se që atëherë një miqësi mjaft e bukur është instauruar mes nesh. Kam jetuar momente të bukura me të, që kur e takova për herë të parë me qëllim që t'i shpreh dëshirën time për t'u bërë meshtar e deri në këto momente kur ai me shumë dashamirësi e kujdes baritor vazhdon të vizitojë bashkësinë tonë të Shën Kollit në Breg të Matës.

E si të mos më godiste titulli "Ngjarje në tokë", në këtë periudhë të jetës sime, në të cilën po reflektoj thellësisht mbi botën shpirtërore të njeriut, mbi realizimin e personit, mbi vuajtjen në botë? E si të mos më godiste në këtë periudhë kur gjithnjë e më shumë po verifikoj se jeta e personit njerëzor me të vërtetë është një ngjarje në Univers brenda universit? Me këtë titull, do të mund të shkruheshin sa e sa libra. Se jeta e çdo njeriu, shpirti, karakteri, sjellja etj., janë jo vetëm një ngjarje, por një botë, një univers unik.

Po, personi njerëzor është një Univers, eksplorimi i të cilit përfundon me atë realitet që e thërrasim Vdekje. Është ky eksplorim, që Ipeshkvi ynë i dashur, e ka përshkruar duke ndërthurur me harmoni jetën e tij me botën që e ka rrethuar që nga lindja deri në çastet kur ka përfunduar veprën.

## Ngjarje në tokë...

"Ngjarje në tokë" është shprehje që autori e ka përdorur rreth 10-12 herë. Pasi përshkruan një ndodhi, një situatë, një personalitet, thotë: "Ngjarje në tokë". Trajton kështu në mënyrë filozofike çështjet mbi jetën, të mirën, të bukurën, idealin, vuajtjen, dhimbjen.

Njohja e jetës dhe e njeriut, si një ngjarje në tokë, është tema kryesore e librit. Është një ngjarje në tokë lindja e tij, jeta e personazheve që ai citon në libër; ngjarje në tokë, martirizimi i shumë klerikëve dhe i shumë personave të tjerë të pafajshëm; ngjarje në tokë, luftrat e ndryshme që ka përballuar gjatë gjithë jetës...

Personazhi kryesor është Zefi, fëmijë, mësues, meshtar, i burgosur, famullitar, ipeshkëv, studiues, shkrimtar... Personi i Zefit me të gjitha bëmat e tij. Personazhet tjera janë të shumtë, duke nisur nga prindërit, shokët e fëmijërisë, kolegët e punës etj. Përmenden emrat, si: ipeshkvijtë Frano Gjini e Gjergj Volaj. Klerikët tjerë,

si: Mark Hasi, Atë Shtjefën Pistulli, Atë Anton Luli, Atë Anton Harapi, Giovanni Fausti, Daniel Dajani, Mark Çuni, dom Zef Gila, etj.

Një vend të gjerë në veprë e zë figura e Atit të Shenjtë Papës Gjon Pali II, me të cilin ka përjetuar çaste mjaft prekëse, të përmallshme, çaste historike.

Edhe motra e tij, Çilja, është një personazh i jashtëzakonshëm, një figurë e mrekullueshme, me pak fjalë, një motër që ka jetuar me virtyt, duke qenë nder për vëllezërit e saj. Pastaj Gjergji, vëllai, i pari që shugurohet meshtar pas rënies së diktaturës komuniste, ka ecur pothuaj kra-



për krahu me autorin në itinerarin e jetës së tij.

"Nuk shkruaj për njerëzit që kanë ba keq, veç për ndonjë që ka lanë gjurmë të madhe", - thotë autori. E në fakt, ka përdorur pak emra, si: Nesti Havjari, Enver Hoxha, Bardhok Ndue Prendi, Aranit Çela, Mehmet Shehu. Kur flet për komunistat i karakterizon me shumë thjeshtësi e qartësi njëkohësisht: "... shokë njeni me tjetrin, pa qenë kurrë vëllazën". Pastaj për "kulturën" që komunizmi do të sillte: "Çka asht kjo kulturë e egër që nuk ka ekzistue asnjëherë?". Por, ka përdorur edhe emra personash që "nuk kanë histori". Me kuptimin se ka cituar emra që nuk kanë popullaritet, megjithëse me shembullin e tyre kanë ndërthurur në heshtje një histori që më vonë do të flasë. E, një ndër këta është Z. Ndrecë Haxhari nga Rragami, njeri që ka

lënë gjurmë për mirë kudo që ka shkelur, kudo që është shprehur, kudo që ka vepruar. Ka kryer gjatë kohës së regjimit komunist, mes persekutimesh, një veprimtari të palodhshme për shpalljen e fesë, në dhënien e katekizmit fshehtas e sidomos në ndihmën e qëndrueshme ndaj meshtarëve të burgosur.

Përfitoj të komunikoj, ndër të tjera, se pikërisht ky burrë, që më pëlqen ta quaj burrë Kishe, e për të cilin Mons. Zef Simonin ka një stimë shumë të madhe, më ka pagëzuar një natë shtatori, kur gjendeshim për t'u lutur fshehurazi mbi gërmadhat e shenjtërores së Shenjtes Eufemi në Kallmet. Edhe kjo "ngjarje në tokë"...

Duke mos u zgjatur, mund të themi se autori ka vlerësuar me shpirt të gjithë ata që e kanë ndihmuar dhe i kanë bërë mirë në çdo moment të jetës së tij, pa gjykuar kurrë ata që i kanë bërë keq.

## Një roman origjinal... diçka më shumë

Përveçse një përshkrim historik, libri është një refleksion i thellë mbi jetën, mbi lindjen e vdekjen, mbi traditat dhe kulturën tonë, është një refleksion i thellë mbi realitetin shpirtëror të personit.

Kushedi sa shqiptarë do të mund të gjenin veten në veprën që po analizojmë! Dhe jo vetëm ata që kanë vuajtur nëpër burgje, internime, në punë të sforcuara, port ë gjithë për arsye se në të gjenet e gdhendur artistikisht një jetë e tërë, një jetë e sprovuar në Kalvarin e mundimeve komuniste.

Ideja kryesore e librit, - e thotë vetë autori, - është Providenca (Provania ose parashikimi i Zotit). "Kam pasë parasysh të shkruajsh këto vepra me një ide të madhe, shkruan, atë të Providencës. Kjo edhe e shpëton nga një autobiografi,

nga çdo mërzë dhe shtien veprën në realitetin e historisë dhe të vlerave të saj".

Një meritë të madhe e ka Ipeshkvi për përshkrimin e sinqertë të mundimeve të tij shpirtërore... madje edhe për të metat e tij, që ndoshta nuk meritojnë të quhen të meta, por modestia ia lejon t'i konsiderojë si të tilla.

Si një shprehje e pasionit të tij për letërsinë, me kompetencë të veçantë e plot mjeshtri, analizon shkurtimisht e në mënyrë koncize mendimet e veprat e shumë shkrimtarëve shqiptarë. Gjithashtu përshkruan me hollësi detyrat e meshtarit, ku Zoti edhe e ka thirrur.

Lidhur me gjuhën ndoshta nuk jap një gjykim objektiv. Sidoqoftë kufizohem duke thënë se fjalitë janë të ndërthuara me art e të ngarkuara me mendim filozofik. Në përgjithësi, është gjuhë e rrjedhshme.

Nëse nuk gabohem, mund të konsiderohet një shkodarçe letrare.

Përdor me bollëk figurat letrare, sidomos antitezat, gje që bën të mundur përshkrimin realist të jetës e të situatave të ndryshme në të cilat gjendet autori dhe ambienti jetësor i tij.

Me shumë shije flet për letërsinë, duke e konsideruar "një forcë në art". Libri ka një vlerë të jashtëzakonshme historike. Shumë lexues (të moshave të reja), që nuk e kanë përjetuar periudhën e sundimit komunist në Shqipëri, mund të gjejnë në këtë veprë një material të gjerë me të dhëna të sakta, me data, emra, përshkrime etj.

Një vlerë të rrallë për historinë e Kishës në Shqipëri (gjatë periudhës kur shteti ynë u shpall ateist) e ka kapitulli V me të ashtuquajturin "Revolucion kulturor" dhe me mbylljen e Kishave.

Dëshiroj, së fundi, të falënderoj me gjithë zemër Imzot Zef Simonin për dhuratën që na ka bërë nëpërmjet këtij romani autobiografik. Personalisht i jam mirënjohës (besoj bashkë me mua edhe të gjithë ata që e kanë njohur) në mënyrë të veçantë për dhuratën e jetës së tij që është një dëshmi e gjallë për të gjithë.

Me shpresën dhe dëshirën e zjarrtë që kombi ynë të ngrihet në kohën e duhur, në të gjitha fushat... duke ia besuar Hyjit të Gjithëpushtetshëm në këtë Vit Jubilar, Atij që është i aftë "të pastrojë kujtesën" e një historie që shpeshherë gjatë shekujve nuk ka bërë histori.

Me respekt dhe dashuri, i bashkuar me Ju në Krishtin e në Zojën e Bekuar,

NIKOLIN SH. LËMEZHI

POEZI nga Nikolin Lëmezhi

## Ndëshkohet mëkati dhe jo mëkatari...

Kur plumbat kërcasin e të pafajshmit vdesin. Gurët diçka flasin, ndërsa njerëzit heshtin...

Lirohen nga burgu e prapë këtu vrasin. Dikur vriste turku, tash vëllavrasjen ngasin.

Sëshhtë kush aq fajtor sa jeta t'i merret dot, se brenda bart shpresë si zjarri që s'digjet kot.

Prano të Vërtetën si burrë ki guxim: Fajtorit falja jetën, por ndreqi gabimin! Krishti qe fati na mësoi i pari: "Ndëshkohet mëkati dhe kurrë mëkatari".

## Lum ai që gjen Heshtjen!

Sa shumë "zhurmë" për një prift që largohet: A nuk është vallë Heshtja më shprehëse se çdo zhurmë? A nuk është Heshtja përgjigjja më e bukur? Në Heshtje gjithçka gjen kuptim.

# Risite në shkencat ekonomike përmirësimi i treguesve - sjellin zhvillim dhe prosperitet.

PROSPERITETI I NJË SHOQËRIE MATET NË BAZË TË PRODUKTIT TË BRENDSHËM BRUTO (PBB) DHE KONCEPTI DHE FORMULAT

Mangësitë e PBB për të matur realitetin. Esse akademike e plote me citime analize, përfundime dhe rekomandime pajisur me shembuj e tabele krahasuese në Shqipëri krahasuar me vendet e rajonit dhe të BE-së, sipas një bibliografi analitike.

Një esse akademike e plotë mbi prosperitetin, PBB-në (Prodhimin e Brendshëm Bruto), mangësitë e tij për të matur realitetin ekonomik dhe krahasimet me Shqipërinë, rajonin dhe BE-në, është strukturuar me analizë, citime, shembuj dhe rekomandime. Prosperiteti i një shoqërie dhe roli i Produktit të Brendshëm Bruto (PBB):

1. Hyrje Prosperiteti i një shoqërie përcaktohet nga aftësia e saj për të prodhuar dhe distribuuar vlerë ekonomike që përmirëson mirëqenien e banorëve.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), si tregues ekonomik, mat vlerën totale monetare të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda kufijve të një vendi gjatë një periudhe të caktuar kohore. PBB për frymë përfaqëson PBB e ndarë me numrin e popullsisë, dhe shërben si indikator bazë i fuqisë ekonomike dhe potencialit ekonomik të një vendi.

E megjithatë, e di mirë, se nuk ka humbje të mundshme për atë që gjën Heshtjen!

Nikolin Sh. Lëmezhi  
Shkodër, 04. 02. 2026

## O njeri, mos pusho!

(autor: Gandhi)

Qoftë nëse je i lodhur apo jo, o njeri, mos pusho, mos u ndal në luftën tënde të vetmuar,

vazhdo përpara dhe mos pusho!

Do të ecësh nëpër shtigje të paqarta e të ndërlikuara dhe vetëm disa jetë të trishta do të shpëtosh.

O njeri, mos e humb fenë, mos pusho!

Vetë jeta jote do të shterohet e do të venitet dhe do të ketë rreziqe në rritje gjatë rrugës. O njeri, duroje gjithë këtë, mos pusho!

Kalo përmbi vështirësitë edhe kur të jenë më të larta se malet, dhe edhe nëse përtej ka vetëm fusha të thata e të shkreta!

Bota do të errësohet dhe ti do të derdhësh dritën tënde mbi të, dhe errësitat do të shpërndahen. O njeri, edhe kur jeta jote të jetë në rrezik, mos pusho!

Kërko pushim për të tjerët!

2. Koncepti dhe formula të PBB-së:

2.1- PBB – Përkufizimi dhe komponentët PBB mund të llogaritet përmes tre qasjeve kryesore: Qasja e shpenzimeve: “PBB”= C+I+G+(X-M) ku:



Tabela krahasuese e PBB-së për frymë (USD / 2025 )

Vendi	PBB për frymë (USD)	Status
Shqipëria	~10 000 – 10 500	nën mesataren botërore/BE
Mali i Zi	~13 500	mbi Shqipërinë
Serbia	~14 174	më i lartë se Shqipëria
Bosnja & Hercegovina	~8 362	më i ulët
BE mesatare	~40 000+ (variabël)	shumë më e lartë

- C = Konsumi i familjeve;
- I = Investimet bruto;
- G = Shpenzimet e qeverisë;
- X = Eksportet;

M = Importet Qasja e të ardhurave. – PBB llogaritet përmes të ardhurave totale të fituara nga faktorët e prodhimit: paga, fitimet, qiratë, e të tjera. Qasja e vlerës së shtuar – Totali i vlerës së shtuar në çdo sektor të ekonomisë.

2.2- PBB për frymë “PBB për frymë” = “PBB totale” / “Popullsia”. Ky tregues përdoret për krahasime ndërkombëtare të standardit të jetesës dhe paraqet bazën për shumë analizë politikat ekonomike.

3. Mangësitë e PBB-së si tregues i prosperitetit. Edhe pse PBB është një indikator ekonomik kyç, ai ka limite të konsiderueshme kur përdoret për të vlerësuar mirëqenien dhe prosperitetin real të shoqërisë. 3.1 Disavantazhet kryesore të PBB-së:

a) PBB nuk mat mirëqenien njerëzore PBB nuk përfshin faktorë që ndikojnë, në cilësinë e jetës, si shëndeti, shkollimi, apo lumturia – aspekte që janë thelbësore për mirëqenien sociale.

b) PBB nuk reflekton pabarazinë. Dy vende me të njëjtin PBB për frymë mund të kenë shpërndarje të shumë ndryshme të të ardhurave. PBB për frymë fsheh pabarazitë në brendësi të një shteti.

c) PBB reflekton vetëm aktivitetet e formalizuara Një pjesë e madhe e ekonomisë së pakontabilizuar në vendet në zhvillim (p.sh. shitje informale ose punë shtëpiake) nuk raportohet zyrtarisht dhe për pasojë nuk përfshihet në PBB.

d) PBB injoron kostot mjedisore Veprimtaritë që çojnë në dëmtim afatgjatë të natyrës (si ndotja ose shfrytëzimi i ujërave) mund të rritin PBB në të njëjtën kohë që ulin mirëqenien.

e) PBB nuk mat mirëqenien subjektive Perceptimi i banorëve rreth jetës, si lumturia apo koha e lirë, mbetet jashtë llogaritjeve të PBB-së. Kjo pengon një vlerësim holistik të prosperitetit.

4. Shembuj të PBB-së: Shqipëria, rajoni

dhe BE-ja:

4.1 Shqipëria — Të dhëna bazë të PBB-së:

• Data zyrtare nga INSTAT tregon se vlera e PBB-së në Shqipëri në vitin 2023 ishte rreth 2.364.275 milionë lekë dhe në 2024 rreth 2.517.821 milionë lekë, duke pasqyruar rritje në terma nominalë dhe realë.

• PBB për frymë në 2025 për Shqipërinë raportohet rreth 10. 527 dollarë, që është nën mesataren botërore dhe dukshëm nën mesataren e BE-së. Vlerat tabelare krahasues ndryshojnë sipas vendit dhe kohës raportuese . Tabela krahasuese nr. 1 ne fund te studimit . 4.2 Pozita e Shqipërisë në Evropë. Sipas të dhënave të IMF për vitin 2025, Shqipëria renditet ndër vendet me të ardhura për frymë relativisht të ulëta në Evropë, rreth 28 % e mesatares së BE-së.

5. Përfundime analitike Nga analiza mbi PBB dhe mangësitë e tij për të matur prosperitetin e një shoqërie del qartë se: PBB është një tregues i fuqisë ekonomike dhe aktivitetit të biznesit, por nuk është një matës i mirë i mirëqenies ose cilësisë së jetës. Shqipëria ka performancë të ulët të PBB-së për frymë krahasuar me BE-në dhe disa vende të rajonit, duke sugjeruar nevojën për përmirësim ekonomik dhe social. Për të vlerësuar realitetin social dhe prosperitetin e një vendi, kërkohen indikatorë që kapin përtej vlerave monetare të prodhimit, përfshirë shëndetin, arsimin, pabarazitë sociale dhe efektet mjedisore.

6. Rekomandime politike Përdorimi i indikatorëve suplementarë: Vendosja e treguesve si Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (HDI) ose Genuine Progress Indicator (GPI) së bashku me PBB për një vlerësim më të plotë të prosperitetit. Monitorimi i pabarazive: Ndërmarrja e politikave për uljen e pabarazisë dhe mbështetjen e klasave me të ardhura të ulëta për të ulur boshllëkun midis rritjes ekonomike dhe mirëqenies. Investime në kapital njerëzor: Përmirësimi i arsimit dhe shëndetësisë për të rritur produktivitetin dhe cilësinë e jetës. Politika të gjelbra dhe të qëndrueshme: Marrja parasysh e kostove mjedisore në vendimmarrje, duke shmangur dëmtimin e natyrës që nuk reflektohet në PBB. Në këtë mënyrë, PBB vazhdon të jetë një mjet i rëndësishëm për matjen e aktivitetit ekonomik, por sidomos në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies sociale, duhet të shoqërohet me tregues komplekse dhe gjithëpërfshirës që reflektojnë realitetin socioekonomik të një vendi.

Dr. KUJTIM ÇAKO

# Robert Elsie - figura më e rëndësishme ndërkombëtare e studimeve për kulturën veriore shqiptare

Vijon nga nr. 269

**Elsie u bë urë lidhëse: ndërmjet kulturës së Veriut dhe akademisë botërore.**

Ai shkroi në anglisht për: epikën shqiptare, traditat e fiseve, zakonet, letërsinë e vjetër të Veriut, figurat historike të malësisë. Kjo e bëri kulturën veriore të kuptohet dhe vlerësohet jashtë kufijve të Shqipërisë.

Thethi ishte vendi ku ai ndjehej më shumë si në shtëpi. Ai e përshkruante atë si: "Kodra dhe lugina ku e ndiej se koha ndalon." Ai: qëndroi shpesh atje, zhvilloi kërkime mbi traditën e Shalës dhe Shoshit u miqësua ngushtë me banorët, e quante Thethin "zemra e kulturës veriore". Dëshira e tij testamentare që hiri të shpërndahej pikërisht në Theth, është dëshmia më e fortë e lidhjes së tij me Veriun.

Interesi i Robert Elsiut, për kulturën veriore shqiptare nisi shumë herët, menjëherë pas kontakteve të tij të para me gjuhën shqipe dhe me literaturën etnografike. Vizita e tij e parë në Shqipëri, u përqendrua kryesisht në zonat alpine, të cilat ai i konsideronte si hapësira të "autenticitetit të pakrahueshëm kulturor". Ndryshe nga shumica e studiuesve të huaj, që vizitonin qytetet kryesore, Elsie u tërhoq nga zonat e thella malore, si: Shala, Shoshi, Pulti, Shllaku e Temali, Mirdita, Kelmendi, Malësia e Madhe, Trovoja, Pulti i Sipërm, Shkodra si qendër e kulturës tradicionale katolike. Këto udhëtime jo vetëm i dhanë atij njohje të drejtpërdrejtë me terrenin kulturor të Veriut, por e çuan në kontakte të gjera me pleq, rapsodë, klerikë dhe bartës të traditës gojore. Më vonë, ai do të shkruante se "çdo takim në malësi ishte si hapja e një libri të gjallë". Këto përvoja u bënë bazë për studimet e tij në epikë, traditë, strukturë fisnore dhe kulturë të trashëguar.

Gjatë kërkimeve të tij, Elsie bashkëpunoi me një numër të madh studiuesish, lokalë dhe institucionalë, të cilët e ndihmuan të qasej më thellë në materialin autentik të Veriut. Kontaktet më të rëndësishme përfshinin: studiues të Institutit të Kulturës Popullore në Shkodër; klerikë katolikë që i hapën arkivat e famullive; rapsodë dhe familje që ruanin këngë, legjenda dhe dokumente të vjetra; njohës të Kanunit dhe traditave fisnore. Ai u lidh posaçërisht me qarqet kulturore shkodrane, të cilat i ofruan qasje në materiale të rralla, dorëshkrime të padeklasifikuara


më parë dhe dokumente kishtarë që shërbyen si burime primare në botimet e tij të mëvonshme.

Këto bashkëpunime ishin reciproke: studiuesit e Veriut gjetën tek Elsie një ndërmjetës të aftë që e prezantoi traditën e tyre në akademinë ndërkombëtare, ndërsa ai gjeti tek ta burime të pasura të

gjuhës dhe kulturës tradicionale.

**Ndër të gjitha hapësirat që Robert Elsie vizitoi, Thethi mbeti vendi që ai do ta quante "shtëpia shpirtërore". Ai e përshkruante Thethin si një arkiv të hapur të kulturës malësore, ku gjuha, traditat, tiparet shoqërore dhe natyra ishin ruajtur pothuajse të pacenuara.**

Aty ai: kaloi periudha të gjata pune kërkimore; zhvilloi takime me bartës të këngëve kreshnike; mbledhi materiale për studimet e tij mbi Kanunin; krijoi lidhje miqësore me familje të vjetra të fshatit; studioi ritin e mikpritjes dhe strukturën tradicionale të kuvendit malësor. Dashuria e tij për këtë vend u shpreh kulmorisht



kur, para vdekjes, la amanetin që hirin e tij ta shpërndanin në Theth - një gjest që simbolizon lidhjen e pazgjidhshme, që ai ndante me kulturën veriore.

Kontakti i ngushtë me Veriun ndryshoi drejtimin e punës akademike të Robert Elsi. Në vend të një fokusi thjesht gjuhësor, ai e orientoi karrierën drejt: studimit të epikës heroike; botimit të përmbledhjeve të rapsodëve veriorë; përkthimit të letërsisë së vjetër katolike; analizës së dokumenteve të klerit verior; studimit të strukturave fisnore dhe trashëgimisë zakonore.

Në këtë kuptim, Veriu nuk ishte vetëm një objekt kërkimi; ai u bë shtylla që përcaktoi identitetin e tij si albanolog. Studimet mbi epikën heroike veriore (Këngët e Kreshnikëve)

Një nga kontributet më monumentale të Robert Elsi, është puna e tij me epikën heroike të Veriut, e njohur si "Këngët e Kreshnikëve". Para Elsi, epika ishte studiuar pjesërisht nga studiues shqiptarë (Z. Sako, Q. Hoxha, A. Doja e të tjerë), si edhe nga ekspedita e Parry-Lord në vitet '30. Por Elsie bëri diçka themelore: Ai publikoi për herë të parë një përmbledhje të plotë, të sistemuar dhe të përkthyer në anglisht të epikës kreshnike. Ky botim: e bëri epikën shqiptare të qasshme për studime ndërkombëtare; i dha Veriut të Shqipërisë një status të ri në studimet ballkanike; dokumentoi variante të plota të këngëve, të mbledhura në terren; krahasoi epikën shqiptare me atë boshnjake, serbe dhe malazeze.

Elsie aplikoi një metodë të kombinuar: transkriptim i besueshëm i tekstit gojor, duke ruajtur dialektin gegë; përkthim analitik, jo stilistik, për saktësi shkencore; analizë krahasimtare me traditat e Evropës Juglindore; komentare etnografike për çdo personazh, toponim dhe motiv.

Epika veriore u ngrit nga folklor popullor në objekt shkencor me status ndërkombëtar, dhe kjo ishte një nga arritjet më të mëdha të tij.

Kontributi i Elsi në studimin e Kanunit të Veriut është i shumëfishtë: Ai botoi dhe përktheu materiale të rralla të klerit katolik mbi Kanunin

Këto përfshijnë: dorëshkrime nga Atë Shtjefën Gjeçovi; tekste dhe komente të jezuitëve dhe françeskanëve shkodoranë; botime historike të periudhës 1610-1930 mbi të drejtën tradicionale; dokumente të misioneve katolike në malësi.

Ky punim i tij e ndihmoi personelin akademik të kuptojë: strukturën e kuven-dit malësor; funksionimin e besës, nderit dhe gjakmarrjes; marrëdhënien midis Kanunit dhe Kishës katolike; mënyrën se si Kanuni u transmetua ndër shekuj.

Ndryshe nga studiuesit lokalë që e shihnin Kanunin si normë juridike, Elsie e trajtoi atë si: sistem kulturor, identitet kolektiv, model organizimi shoqëror, artefakt etnografik i një shoqërie të lashtë indo-evropiane. Kjo qasje e tij futi Kanunin e Veriut në literaturën botërore të antropologjisë.

Robert Elsie botoi ose përktheu qindra tekste të autorëve të Veriut: Letërsia e



Robert Elsie e Gjon Marku, me 9 gusht 2014, në Prishtinë, në Konferencën, me temë "Eposi i Kreshnikëve"

vjetër katolike. Ai përgatiti botime kritike dhe përkthime të: Pjetër Bogdanit, Pjetër Budit, Frang Bardhit, Lekë Matrëngës, Gjon Nikollë Kazazit, bazuar në dorëshkrimet e vjetra të Shkodrës, Kosovës dhe Arkivit të Vatikanit.

Ai përktheu dhe promovoi autorë bashkëkohorë: Martin Camaj, Ernest Koliqi Kolec Traboini (në studime të veçuara), Atë Zef Pllumi, Rapsodët shkodoranë dhe tropojanë. Këto botime i dhanë letërsisë veriore ekspozim në universitete dhe biblioteka të vendeve perëndimore.

Sërish, një nga arritjet më të rralla të Elsi është krijimi i një arkivi të hapur digjital për kulturën shqiptare, veçanërisht për Veriun: "Albanian Texts Online" dhe "Albanian Folklore". Në këto arkiva ai vendosi: fotografi të vjetra të Veriut; këngë epike dhe lirike; dokumente historike; shkrime të klerit katolik; harta etnografike dhe shpjegime të termologjisë malësore.

Ky projekt shndërroi Elsi në krijuesin e arkivit më të madh publik të trashëgimisë veriore, duke siguruar që burimet të mos humbisnin kurrë.

Puna e tij pati ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si bota e sheh Veriun e Shqipërisë: E futi epikën veriore në hartën e studimeve indo-evropiane. Promovoi kanunin si kod juridik unik në Evropë. Vendosi Shkodrën dhe Thethin në literaturën etnografike botërore. E prezantoi poezinë veriore për audiencë akademike amerikane dhe evropiane. Ndikoi në programet studimore në universitete të ndryshme. Në thelb, ai ishte zëri që lidhi Veriun me botën. Vlerësimet e akademikëve shqiptarë

Studiuesit shqiptarë, veçanërisht ata të traditës shkodorane dhe të institucioneve albanologjike, kanë dhënë vlerësime të shumta për punën e Robert Elsi. Në përgjithësi, këto vlerësime përqendrohen në disa pika kyçe: Aftësia për t'i dhënë kulturës veriore dimension ndërkombëtar.

Shumë studiues theksojnë se pa punën e Elsi, epika heroike, letërsia e vjetër katolike dhe trashëgimia zakonore e Veriut nuk do të kishin hyrë në qarkullimin akademik botëror. Ai u bë "përkthyesi kulturor" i Veriut.

Etnologë dhe filologë shqiptarë vlerësojnë: përkthimet e sakta, pa deformime; dokumentimin e plotë të burimeve; ruajtjen e dialektit gegë; paraqitjen korrekte të realiteteve shoqërore të malësisë. Në këtë aspekt, puna e tij konsiderohet model profesionalizmi.

Elsie shpesh gjeti dhe botoi tekste të panjohura më parë, si dorëshkrime të klerit shkodoran dhe dokumente të hershme latine. Studiuesit e vjetër të Shkodrës e vlerësuan këtë si "shpëtim të një pjese të trashëgimisë kombëtare".

Në qarqet ndërkombëtare, vlerësimi për Elsi është po aq i lartë. Si autoritet kryesor i gjuhës dhe kulturës shqiptare, Qendra evropiane dhe amerikane e konsiderojnë Elsi si: albanologun më të rëndësishëm të gjeneratës së tij; studiuesin me bibliografinë më të gjerë në fushën e shqipes; ekspertin kryesor të epikës së Ballkanit Perëndimor.

Universitetet perëndimore vlerësojnë shumë faktin që ai: krijoi arkivin më të madh digjital të kulturës shqiptare; garantoj qasje të lirë dhe falas për studiuesit e botës; solli transparencë dhe hapje ndaj burimeve primare. Ky është kontributi jashtëzakonshëm në humanitete.

Ai mbetet figura qendrore e studimit të Veriut të Shqipërisë në shekullin XXI. Asnjë studiues i huaj nuk ka prodhuar kaq shumë materiale: epike, letrare, gjuhësore, historike, zakonore, etnografike.

Ka krijuar bazën që studiuesit shqiptarë e të huaj mund të përdorin për dekada.

Shumë nga materialet e botuara ose digjitalizuara prej tij nuk do të ishin të qasshme ndryshe.

Pa Robert Elsi, njohja e Veriut shqip-

tar do të ishte shumë më e varfër.

Studimi i kontributit të Robert Elsi në fushën e albanologjisë dhe sidomos në hulumtimin e Veriut të Shqipërisë përbën një ndër temat më të rëndësishme të kërkimit bashkëkohor mbi kulturën shqiptare. Vepra e tij, e shtrirë në gati pesë dekada, ka krijuar një urë të fuqishme ndërmjet trashëgimisë veriore dhe botës shkencore ndërkombëtare, duke e shndërruar Elsi në figurën qendrore të studimeve për kulturën gojore, letërsinë e vjetër dhe dokumentet historike të Veriut.

Nga analiza e kryer rezultojnë se kontributi i tij shfaqet në disa dimensione kryesore: Epika heroike veriore. Elsie botoi dhe përktheu korpusin më të plotë deri sot të Këngëve të Kreshnikëve, duke i dhënë epikës shqiptare status akademik në nivel botëror. Kjo epikë, e cila përfaqëson identitetin kulturor të malësisë dhe të trevave kreshnike, falë punës së tij, tashmë studiohet në universitete të Evropës dhe Amerikës. Kanuni dhe kultura zakonore. Ai solli dokumente të panjohura më parë, analizoi strukturën e organizimit fisnor dhe ndihmoi që Kanuni i Lekë Dukagjinit të kuptohej si sistem kulturor e shoqëror kompleks, jo vetëm si kod juridik. Falë tij, Kanuni u përfshi në studimet ndërkombëtare të antropologjisë së drejtës. Letërsia e vjetër katolike dhe tradita shkodorane, Përmes përkthimeve dhe botimeve të autorëve të Veriut (Budi, Bogdani, Bardhi etj.), ai i ktheu këto tekste në pjesë të fondit kulturor evropian, duke evidentuar rolin historik që Shkodra dhe kleri katolik luajtën në formimin e gjuhës dhe identitetit shqiptar.

Elsie krijoi një arkiv të hapur elektronik unik në llojin e vet, ku dokumentoi historinë, folklorin, gjuhën dhe letërsinë e Veriut. Ky arkiv është sot një nga burimet më të rëndësishme për studiuesit.

Përtej punës shkencore, Veriu u bë për Elsi vend identitar dhe shpirtëror.

Udhëtimet e tij të shpeshta në Theth, Shalë, Malësinë e Madhe dhe Shkodër ishin jo vetëm ekspedita kërkimore, por edhe proces i përvetësimit emocional të një kulture që ai e vlerësonte si unike në Evropë. Amaneti i tij që hiri të shpërndahet në Theth është dëshmi e lidhjes së tij të thellë me këtë krahinë. Kjo dimension personal e bën veprën e tij edhe më të besueshme, sepse nuk është thjesht punë arkivore: është pasion, përkushtim dhe respekt për një trashëgimi të lashtë.

Në përmbledhje, Robert Elsie është: figura më e rëndësishme ndërkombëtare e studimeve për kulturën veriore shqiptare; promovuesi i parë i epikës veriore në botën anglishtfolëse; botuesi më i plotë i materialeve të klerit katolik të Veriut; krijuesi i arkivit më të madh digjital të kulturës shqiptare; lidhja më e fortë ndërmjet Veriut shqiptar dhe akademisë perëndimore.

Vepra e tij nuk është thjesht albanologji: është ruajtje e identitetit kulturor të një populli. Prandaj, rëndësia e punës së tij do të mbetet aktuale edhe për brezat e ardhshëm.

Nga Gjon Marku



Marjeta Gjeka asht një artiste shkodrane, e cila e përdor shkrimin si mjet introspeksioni dhe si mënyrë për me u kthye vazhdimisht te vetja, te gjuha dhe te rrânjët e saj. Në poezinë e saj, fjala nuk asht veç shprehje, por kujtim, mall dhe lidhje e gjallë me vendlindjen.

E lidhun ngushtë me poezinë bashkëkohore, artet pamore dhe ndjeshmëninë artistike, ajo ndërton një univers ku gjuha shqipe, mërgimi dhe përkatësia ndërthuren me dritën, heshtjen dhe kujtesën. Tekstet e saj lindin prej përvojës së

largësisë, tue e kthye mallin në poezi dhe kujtimin në prani të përhershme.

Përmes një gjuhe të thjeshtë, por të ngarkueme me ndjenjë, trajton tema si identiteti, koha, rrugëtimi dhe kthimi duke krijuar vargje që nuk lexohen vetëm, por ndihen si jehonë e brendshme.

Në qendër të krijimtarisë së saj qëndron lidhja e pashmë me rrânjët dhe me Shkodrën, e cila në poezinë e saj shfaqet si kujtesë, si frymë dhe si shtëpi shpirtërore që nuk largohet kurrë.

Kjo përmbledhje poetike lind prej një zani të brendshëm që vjen si jehonë e gjuhës, e kujtesës dhe e vendit. Në këto vargje, fjala nuk asht vetëm mjet shprehjeje, por frymë që mban gjallë lidhjen mes njeriut dhe rrënjëve të tij.

Në qendër të këtij cikli qëndron gjuha shqipe si identitet i gjallë, si kujtim i trashëguem dhe si dritë që nuk shuhet, edhe kur rrugët e jetës largojnë njeriun prej atdheut. Prej andej lind edhe malli, që nuk shfaqet vetëm si dhimbje mungese, por si forcë që e rikthen shpirtin vazhdimisht te origjina.

Një vend i veçantë në këtë përmbledhje zë edhe përjetimi i mërgimit, heshtja e qyteteve të huaja dhe kërkimi i vazhdueshëm i vetvetes në fytyra, vende e kujtime që nuk zëvendësohen kurrë. Në këtë udhëtim të brendshëm, figura e nanës dhe zani i saj bëhen thirrje e përhershme kthimi.

Në zemër të këtyne poezive rri edhe Shkodra, jo vetëm si qytet, por si kujtesë, si muzikë dhe si shpirt. Ajo shfaqet në ujërat e Bunës e Drinit, në hijen e Rozafës dhe në përditshmërinë që shndërrohet në art. Përmes saj, vendlindja merr trajtën e një ndjenje që nuk largohet kurrë.

Këto poezi nuk synojnë me dhanë përkufizime të mbyllura, por me hapë dritare ndjesish. Ato janë copëza jete, malli dhe dashnie, të shkrueme me besimin se fjala mundet me i mbajtë gjallë ato që koha dhe largësia mundojnë me i zbehë. Në fund, kjo përmbledhje asht një kthim: te gjuha, te rrënjët dhe te vetja.

#### Jehona e Shqipes

Si agim që lind mbi troje t'lashta,  
nji za i ambël që shpirtin zgjon,  
shqipja rrjedh ngjak si kangë e hershme,  
dhe nçdo zemër përherë tingëllon.

Jehonë mali n'fjalën e lashtë,  
nji za që s'shuhet n'kohë as n'stuh,  
shqipja kumbon si kangë e përjetshme,  
n'zemrat tona me dritë e fuqi.

Prej bjeshkëve t'nalta te brigjet e detit,  
ajo rrjedh si ujë i pastër ndër gurë,  
mbart kujtime, histori e betime,  
si flamur që s'u përkul kurrë.

Nçdo fjalë fshihet mall e qëndresë,  
nji flakë që ndizet brez pas brezi,  
shqipja s'asht veç nji gjuhë që thuhet,  
por shpirt i gjallë që rron përjetë e kurrë s'shuhet.

Jehona e saj n'botë përhapet,  
si thirrje që vjen prej thellësisë s'dheut,  
nji lidhje e fortë që na mban bashkë,  
si rrânjë t'thella n' trungun e atdheut.

Edhe kur hesht çdo za tjetër,  
ajo mbetet si dritë n'pafundësi,  
nji jehonë e gjallë që s'njeh harresë,  
shqipja jonë, përherë n'amësi.

E kur largësia na ndan me dhimbje,  
ajo na rikthen te kujtimet,  
se gjuha jonë asht vetë atdheu,  
që rreh n'zemër si dashni pa mbarim.

**Shënim:** Kjo poezi lindë prej dashnise teme për gjuhën shqipe, që për mue asht shpirti i kombit e flaka që ndriçon brez pas brezi. Çdo fjalë, çdo jehonë, mban me vedi historinë, kujtimet e forcën që na mban bashkë. Edhe kur largësia na ndan, gjuha jonë na rikthen gjithmonë te rrânjët e dashnia për atdheun.

#### Larg atdheut

N'heshtjen e qyteteve t'hueja,  
ku emnat s'kanë kujtime për mue,  
eci vetëm me nji valixhe malli,  
që s'e mbyll ma as koha as rruga.

Flasin gjuhë që s'ma përkëdhelin shpirtin,  
dritat ndizen, po s'kanë ngrohtësinë teme,  
e unë kërkoj nçdo fytyrë t'panjoftun  
nji copë vendi, nji shenj kujtimesh.

Ah, atdhe, ti je si kangë n'largësi,  
që m'ndjek pa za nçdo hap që baj,  
si era që vjen prej maleve t'mia,  
e m'thotë: "mos harro, këtu i ke rrânjët".

E kur nata bjen mbi rrugët e hueja,  
i mbylli sytë e shoh shpinë teme,  
aty ku malli s'asht dhimbje e ftoftë,  
po dashni që nuk shuhet kurrë.

E nse një ditë rrugt m'kthejnë përnjiherë,  
e toka jem m'pret me heshtje n'prag,  
do t'bie ngjuj, jo veç para dheut,  
po para kujtimit që s'vdes kurrë n'zemër.

Se nçdo hap që kam hedhë larg shpisë,  
m'ka ndjek nji za i butë prej s'largu,  
zan' i nanës që i mbushun me mall,  
që m'thërret gjithmonë me u kthye.

E kur t'kthehem, n'qoftë se kthehem,  
s'kam me dashtë ma as fjalë, as botë;  
veç si fmi me u strukë pranë saj,  
me hek krejt mallin n'lot, tuj u rrokë fort.

**Shënim:** Këtë poezi e kam shkruar prej mallit t'mërgimit dhe prej ndjenjës së përkatësisë që nuk shuhet kurrë. "Larg atdheut" flet për lidhjen e përhershme me vendin tem, gjuhën teme dhe rrënjët e mia, edhe kur jam larg. Figura e nanës për mua asht thirrja ma e fortë e zemrës, ajo që m'kthen gjithmonë mbrapa, pa marrë parasysht sa larg kam shkruar. Kjo poezi i kushtohet të gjithë atyne që je-

tojnë larg, po që e mbajnë atdheun brenda vetes çdo ditë.

#### Zani i rrânjëve

Rrânjët e mija n'tokën teme t'vjetër,  
ku hapat e t'parve rrahin n'heshtje,  
ku dielli lind me kangë t'moçme,  
e mbramja zbret me mall e prehje.

Rrânjët e mija n'fusha plot dritë,  
n'mes maleve t'nalta që rrinë n'rojë,  
ku çdo gjethe flet si kujtim i gjallë,  
e çdo rrânjë mban nji emën të shenjtë.

N'këto rrânjë i kam andrrat e plagët,  
aty i kam kangën e lotin,  
se s'janë veç dhe e qiell,  
po shpirt që m'thërret për motin.

Rrânjët e mija s'janë veç vend,  
janë kujtim, janë udhë, janë kthim,  
janë fjalë që kurrë s'harrohen,  
e dashni që s'njeh mbarim.

**Shënim:** E kam shkru këtë poezi si një ndalesë te vetja dhe te rrânjët e mia. Përmes saj kam dashtë me e kujtu tokën që më ka rritë dhe gjurmët që më kanë formu. Është një përpjekje me e shpreh atë ndjenjë të thellë përkatësie, ku kujtimi, dashnia dhe malli bashkëjetojnë brenda meje.

#### Shpirti n'krahët e Shkodrës

Shpirti jem rri n'krahët e Shkodrës,  
aty ku fjala peshon e zemra rreh,  
ku njeriu qesh edhe kur i dhemb shpirti,  
e loti fshihet me humor e besë.

Aty jam rrit mes kangëve e kabanave,  
n'rrugë që flasin me hapa brezash,  
me nji dashni pa fjalë t'mdhaja,  
t'thjeshtë, t'pastër, që kurr s'u nda.

Drini e Buna m'kane msue të mos ndalem kurrë,  
Rozafa të kem durim e të pres me zemër,  
e Shkodra m'ka falë nji mall t'amël,  
që s'plaket kurrë, veç rritet.

Edhe kur jam larg e bota m'thërret,  
zemra jeme kthehet veç n'nji vend,  
te Shkodra jeme, qyteti jem,  
qyteti i zemrës teme përgjithmonë.

O Shkoderlocja jeme, moj zemër,  
nçdo hap t'jetës m'rri n'krahnor,  
edhe larg kur mçon fati,  
aty ku rrjedhin Buna e Drini,  
ku Rozafa rri e historia flet,  
zemra gjithmonë kthehet tek ti,  
sepse shpirti jem rri n'krahët e Shkodrës.

**Shënim:** Kjo poezi është një homazh për Shkodrën, vendin ku u rrita dhe ku zemra jeme gjithmonë gjen strehë. Përmes fjalëve të saj kam dashur të shpreh lidhjen shpirtërore me qytetin, me rrugët, lumenjtë, Rozafën dhe historinë që e ban të veçantë.

Ajo pasqyron dashurinë e pastër dhe të përjetshme për vendlindjen, duke treguar se edhe larg, shpirti kthehet gjithmonë tek krahët e Shkodrës.

#### REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj  
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia  
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,  
Wilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,  
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSOI BOTIMIN:  
N/Kryetari i Këshillit të  
SHAD, sipërmarrësi  
Viktor Arrinaj**

